

# RAPORT I MONITORIMIT TË PROCESIT TË VETINGUT NË POLICI




Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands



# RAPORT I MONITORIMIT TË PROCESIT TË VETINGUT **NË POLICI**



Ky raport u realizua në kuadër të projektit: “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri” i cili mbështetet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

*Qendrimet apo opinionet e shprehura në këtë raport janë të autoreve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.*



**Institute for Democracy and Mediation**  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands

Përgatitën raportin:

**Rovena Sulstarova**  
**Armela Xhaho**  
**Mimoza Agolli**

Kontribuese:

**Iliada Korçari**

Design dhe layout: Eduart Cani

© Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim  
Rr. Shenasi Dishnica No. 1, P.O. Box 8177, Tirana, Albania  
Tel: +355 4 2400241, Tel/Fax: +355 4 2400640  
E-mail: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org)  
website: [www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>I. METODOLOGJIA</b>	<b>6</b>
<b>II: PROCESI I VETINGUT NË POLICINË E SHETIT</b>	<b>7</b>
2.1 Historiku, analiza e nevojës për reformën dhe qasja politike	7
2.2. Kuadri ligjor dhe rregullator për zbatimin e procesit të vetingut	9
2.3 Kuadri Institucional i procesit të vetingut	15
<b>III. ASPEKTE DHE SFIDA TË ZBATIMIT TË VETINGUT NË POLICINË E SHETIT</b>	<b>19</b>
3.1 Skema fillestare e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së sipas ligjit nr. 12/2018 të vetingut në polici	19
3.3 Objekti i vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018 i vetingut në polici, i ndryshuar	21
3.4 Zbatimi i procesit të vetingut në polici	22
3.5 Sfidat gjatë punës së KJV-së	29
3.6. Bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët e interesuar	31
3.7 Vlerësimi i transparencës së proceseve të vetingut	33
<b>IV. PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME</b>	<b>34</b>
Seksioni 1: Kuadri Ligjor dhe Aspekte të Ndërtimit dhe Forcimit të Strukturave të Vetingut	37
Seksioni II: Aspekte të zbatimit vetingut	37
Seksioni III: Aspekte të vlerësimit, ecuria, impakti i deritanishëm dhe i pritshëm, si nga ana e subjekteve të vlerësimit ashtu dhe nga perspektiva e publikut	38

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>BP</b>	Bordi i Përzgjedhjes
<b>DPPSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DSIK</b>	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
<b>ICITAP</b>	Programi i Departamentit Amerikan të Drejtësisë në Ndihmë të Policisë
<b>IDM</b>	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
<b>ILDKPKI</b>	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave
<b>KJV</b>	Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>NA</b>	E pazbatueshme
<b>PAMECA</b>	Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Evropian në Shqipëri
<b>PSH</b>	Policia e Shtetit
<b>PT</b>	Programi i Transparencës
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>SHÇBA</b>	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

# HYRJE

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit “Ndërtimi i integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri”, i mbështetur nga Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, është duke monitoruar procesin e zbatimit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA).

Procesi i vlerësimit kalimtar dhe periodik i punonjësve të këtyre strukturave në varësinë e Ministrisë së Brendshme (MB), që njihet ndryshe si vetingu në polici, përbën një nga instrumentet reformuese të sektorit të rendit publik dhe institucionit të policisë në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e integritetit. Procesi synon të vlerësojë ndikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së nga korrupsioni, krimi i organizuar apo çfarëdolloj veprimtarie tjetër kriminale gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale; integritetin moral dhe përgatitjen e tyre profesionale. Ky veting i trefishtë është i ndarë në tri faza e po aplikohet për herë të parë tek punonjësit e policisë. Për këtë arsye, IDM-ja e ka vlerësuar si tepër të rëndësishëm monitorimin e zbatimit të kësaj reforme në Policinë e Shtetit (PSH).

Në tërësi, vlerësimi kalimtar ka ecur me ritme të ngadalta, duke filluar me rreth 9 muaj vonesë nga afati i parashikuar në ligj. Vonesat u lidhën kryesisht me procedurat e ngritjes së organeve të vlerësimit, nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, si dhe infrastrukturën financiare e logjistike të nevojshme për funksionimin e organeve të vlerësimit. Vonesa ka pasur edhe në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV) dhe sekretariatit teknik. Aktualisht procesi i vetingut është në fazën e parë të implementimit dhe janë përfunduar tashmë rezultatet paraprake të zbatimit të tij në luftën antikorrupsion dhe në forcimin e integritetit në polici.

Përgjatë gjithë procesit të monitorimit 1 mars 2018-1 maj 2020, IDM-ja ka përcjellë raporte periodike 3 mujore, dhe i ka ndarë ato më një numër të

caktuar institucionesh të tilla si Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Parlamenti i Shqipërisë. Gjithashtu, IDM-ja ka vijuar komunikimin me organin zbatues të vetingut, Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, në sajë të të cilit ka mundur të marrë informacion mbi procesin e ndjekur, të konsultojë aktet rregullatore të nxjerra nga ky organ për mbarëvajtjen e procesit, si dhe të marrë sugjerime dhe opinione mbi gjetjet dhe rekomandimet e prezantuara në raportet periodike. Shpresojmë që gjetjet dhe rekomandimet e pasqyruara në këtë raport monitorimi të vijojnë të kontribuojnë në mënyrë modeste në rritjen e efikasitetit të zbatimit të vetingut në Policinë e Shtetit, si dhe në rritjen e besimit të publikut në këtë proces.

Nëpërmjet kësaj nisme, IDM-ja synon të mbështesë transparencën dhe llogaridhënien e organeve të vetingut në Policinë e Shtetit, si edhe të lehtësojë dhënien e informacionit me interes publik në mënyrë objektive.

# I. METODOLOGJIA

Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit integron informacionin dhe të dhënat e mbledhura nga dokumente dhe raporte zyrtare e administrative, inputin e intervistave të thëlluara me përfaqësues të institucioneve dhe grupeve të interesit, si dhe rezultatet e monitorimit të drejtpërdrejtë të seancave të vlerësimit, të realizuara nga IDM-ja gjatë periudhës nëntor 2019 - mars 2020.

Mbledhja e të dhënave u nda në tri faza. Faza e parë përfshiu shqyrtimin e raporteve studimore dhe dokumentacionit strategjik të reformës (dokumente, ligje dhe akte nënligjore). Ajo shërbeu për identifikimin e institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e vetingut në polici, si dhe të aktorëve dhe grupeve të interesit. Në këtë fazë u lexuan me vëmendje dokumentacioni zyrtar procedural, vendimet e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe shënimet e monitorimit të drejtpërdrejtë të seancave të vlerësimit kalimtar. Gjithashtu u mblodhën të dhënat dytësore përmes leximit të raporteve monitoruese të hartuara nga IDM-ja mbi artikujt e botuar në media e nga shoqëria civile përgjatë periudhës së zbatimit të procesit.

Në fazën e dytë, iu kërkuan zyrtarisht të dhëna administrative dhe buxhetore institucioneve të lidhura me procesin e vetingut si: KJV-ja, Bordi Përzgjedhës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, SHÇBA-ja, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Ministria e Brendshme. Të dhënat administrative shërbejnë për vlerësimin e kapaciteteve institucionale, ndërsa ato buxhetore i shërbejnë analizës së efikasitetit financiar.

Institucionet dhe grupet e identifikuara të interesit u përfshinë në fazën e tretë të intervistave të thëlluara, të cilat shërbyen si burim i të dhënave parësore, sidomos në matjen e transparencës, përfshirjes dhe besueshmërisë së procesit. Për këtë qëllim, IDM-ja hartoi një dokument të standardizuar interviste për të mbledhur të dhëna dhe informacion në lidhje me procesin e vetingut në Policinë e Shtetit. Qëllimi i intervistave që i dyfishtë: ato shërbyen si validuese të gjetjeve dhe informacionit të mbledhur në dy fazat e

para të kërkimit, dhe e pasuruan atë me të dhëna administrative. Intervistat e thëlluara qenë veçanërisht të vlefshme për ato aspekte të raportimit ku ishte e pamundur të mblidhej informacion, si dhe për ata indikatorë që synuan vlerësimin e zbatimit të reformës. Në total u zhvilluan 12 intervista të thëlluara që përfshinë: 5 përfaqësues të institucioneve e të strukturave zbatuese të vetingut, 5 subjekte të vetingut që e kanë kaluar vlerësimin, si dhe 2 përfaqësues të grupeve të interesit (media dhe sindikata e punonjësve të Policisë së Shtetit), sipas shtojcës nr. 3.

Informacioni dhe të dhënat e mbledhura u përpunuan dhe u integruan në një matricë vlerësimi, e cila paraqet objektivat kryesore të reformës me indikatorë të matshëm të progresit dhe arritjes së objektivave. Matrica e vlerësimit (shih shtojcën nr. 2) merr për bazë objektivat e përcaktuara të procesit të vetingut në policinë e shtetit dhe i krahason ato me treguesit e progresit, impaktit dhe rezultatet që gjenerohen nga mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, me qëllim vlerësimin e masës në të cilën janë arritur objektivat e synuara gjatë fazës së parë të zbatimit të reformës. Gjithashtu, treguesit kërkojnë të përcaktojnë nivelin e transparencës, paanshmërisë dhe besueshmërisë së procesit, duke qenë se këta elementë të rëndësishëm kanë qenë sfidë e modelit të zgjedhur për të realizuar vlerësimin kalimtar dhe periodik.



# II: PROCESI I VETINGUT NË POLICINË E SHTETIT

## 2.1 HISTORIKU, ANALIZA E NEVOJËS PËR REFORMËN DHE QASJA POLITIKE

Disa nga vendet e bllokut lindor zbatuan qysh në vitet '90 masa të pastrimit të aparatit shtetëror për të lehtësuar kalimin nga sistemi socialist në atë demokratik, nën praktikat e drejtësisë tranzitore. Mekanizmat e përdorur kanë qenë nga më të ndryshmet, si p.sh.: lustracioni, hapja e dosjeve të ish-Sigurimeve të Shteteve përkatëse, rivlerësime të ndryshme (vetingu), amnistitë, pensionimet e detyrueshme të parakohshme, gjyqet etj. Republika e Shqipërisë (RSH) që nga të parat shtete pas-socialiste që ndërmori hapa në këtë drejtim<sup>1</sup> duke themeluar organet e para të vlerësimit të figurës si p.sh. Komisioni për Rivlerësimin e Lejeve për Ushtrimin e Avokatisë (1993) dhe Komisioni Shtetëror për Kontrollin e Figurës (1995). Studiuesit mendojnë kryesisht se përdorimi dhe instrumentalizimi i këtyre organeve dhe ligjeve përkatëse që i themeluan, për të ndëshkuar kundërshtarët politikë, ka bërë që organet të çlegjitimohen<sup>2</sup> e ligjet të shfuqizohen me ndryshimin e partive në pushtet (1997), apo të

shpallen antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese (1998, 2010). Të njëjtët gjykojnë se zbatimi i përkohshëm i ligjeve, më shumë se sa vendosje të drejtësisë, ka sjellë veç fushata spastrimi në administratën publike.<sup>3</sup> Për këto arsye të tjera, Horne beson se RSH nuk ka kaluar përmes një procesi të drejtësisë tranzitore, e klasifikohet në kategorinë jo-raste, në të cilat kushtet e potencialitetit për ndërmarrjen e procesit kanë qenë të larta, por rrethanat e kultura politike nuk e kanë mundësuar implementimin e reformave.<sup>4</sup>

Policia e Shtetit (PSH) ka qenë në fokusin e ligjit të kontrollit të figurës në vitin 1995 dhe që prej asaj kohe, disa ligje të tjera kanë themeluar organe metribute dhe funksione të përgjithshme vetingu, si Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB)<sup>5</sup> në vitin 2001. Në vitin 2010 ky shërbim përgatiti dhe përdori një formular tip për deklarimin e pasurisë nga punonjësit e PSH-së. Mospërputhja serioze e vërejtur veçanërisht tek Policia Rrugore dhe mungesa e mbështetjes ligjore për adresimin dhe thellimin e hetimit e la në harresë deklarimin që nga viti 2011.<sup>6</sup> Në vitin 2014 SHKB-ja u bë Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, duke u

- 1 Ligj nr.7666, datë 26.01.1993, "Për krijimin e Komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë dhe për një ndryshim në ligjin nr.7541, datë 18.12.1991, "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", mund të konsiderohet ligji i parë për vlerësimin e figurës në RSH, fokusi i të cilit ishte gjithsesi shumë i ngushtë pasi kontrollonte veç figurën e avokatit. Ligji i parë me shtrirje të gjerë të vetingut është ligji nr.8043, datë 30.11.1995, "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik".
- 2 Për më shumë, shihni: Austin, R.C. dhe Ellison, J. (2008). Post-communist transitional justice in Albania. *East European Politics and Societies*, 22(2), 373–401. <https://doi.org/10.1177/0888325408315768>; Stan, L. dhe Turcescu, L. (2017). *Justice, memory and redress in Romania: New insights*. Cambridge Scholars Publishing; Stan, L. (Ed.). (2009). *Transitional justice in Eastern Europe and the Former Soviet Union: Reckoning with the communist past*. Routledge.
- 3 Austin, R.C. dhe Ellison, J. Post-communist transitional justice in Albania, f. 398; Stan, L. dhe Turcescu, L. *Justice, memory and redress in Romania: New insights*, f. 50.
- 4 Horne, C. M. (2017). *Building trust and democracy: transitional justice in post-communist countries*. Oxford University Press, f. 106-110.
- 5 Për më shumë shihni ligjin nr.8749, datë 1.3.2001, "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik". [http://www.ikub.al/ligje/103010003/Article\\_Per-sherbimin-e-kontrollit-te-brendshem-ne-Ministrine-e-Rendit-Publik.aspx?cookiesEnabled=false](http://www.ikub.al/ligje/103010003/Article_Per-sherbimin-e-kontrollit-te-brendshem-ne-Ministrine-e-Rendit-Publik.aspx?cookiesEnabled=false)
- 6 Analiza e gjendjes në Policinë e Shtetit, Gardë dhe SHÇBA. (2017, tetor). Ministria e Brendshme, f. 41.

pasuruar me funksione specifike kontrolli pasurie dhe vlerësimi integriteti e profesionalizmi<sup>7</sup>, të cilat “në teori do të mjaftonin për sigurimin e një mekanizmi të shëndoshë vlerësimi dhe kontrolli të brendshëm, por në praktikë gjërat rezultojnë mjaft ndryshe”.<sup>8</sup> Për shkak të mosfunksionimit të këtyre mekanizmave kontrolluese dhe rritjes së vëmendjes publike që Policia e Shtetit mori pas raportimeve, akuzave dhe dëshmimeve për përfshirjen e saj në trafikimin e bimëve narkotike,<sup>9</sup> ministria e linjës ndërmori masa për tejkalimin e kësaj gjendjeje shqetësuese.

Ministri i Brendshëm, me urdhrin nr. 904, datë 15.9.2017 ngriti grupin e punës “Për përgatitjen e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale (“vetting”) të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”. Ky grup u ngarkua me detyrën e kryerjes së një analize gjithëpërfshirëse për të evidentuar gjendjen ekzistuese në strukturat e mësipërme, nevojën dhe thellësinë e ndërhyrjes. Nga analiza e kryer, rezultoi se PSH-ja paraqiste mungesë objektiviteti në analizat e brendshme dhe sistemet e vlerësimit të performancës; pamjaftueshmëri në mekanizmat e kontrollit të brendshëm monitorues; vlerësime negative nga partnerët ndërkombëtarë për aspekte te veçanta të punës, si dhe vlerësime jo pozitive nga shoqëria civile në lidhje me besueshmërinë publike<sup>10</sup>.

Nëpërmjet kësaj analize, Ministria e Brendshme pranoi se Polica e Shtetit, Garda e Republikës dhe SHÇBA-ja kanë probleme me korrupsionin, krimin dhe formimin e pamjaftueshëm profesional, që sjellin siguri të brishtë.<sup>11</sup>

Për të zgjidhur problematikat e evidentuara në të dhe mbështetjen e prokurorëve e gjyqtarëve të dalë nga reforma në drejtësi me punonjës policie të aftë, të ndershëm dhe të përkushtuar<sup>12</sup>, grupi i punës propozoi zbatimin e instrumentit antikorrupsion të vetingut në polici. Zbatimi i tij synonte forcimin efikasitetit të luftës kundër krimit dhe korrupsionit në sektorin e rendit dhe sigurisë, posaçërisht në organet e Policisë së Shtetit. Qëllimi parësor i vetingut në Policinë e Shtetit do të qe garantimi dhe promovimi i integritetit, si edhe rritja e profesionalizmit në radhët e punonjësve të agjencive shqiptare përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.<sup>13</sup> Procesi i vlerësimit të punonjësve të policisë do të zbatohet nga organe të pavarura dhe do të bazohet në kontrollin e figurës, pasurive dhe profesionalizimit të këtyre punonjësve.

Ministria e Brendshme vijoi punën për hartimin e projektligjit për vetingun në polici dhe realizoi konsultime me grupet e interesit. MB-ja raporton të ketë kryer tre aktivitete prezantimi dhe diskutimi publik, ndërkohë që është marrë dhe kontributi i partnerëve ndërkombëtarë si Programi i Komisionit Evropian në Ndihmë të Policisë (PAMECA) dhe Programi i Departamentit Amerikan të Drejtësisë

7 Për më shumë, shihni nenin 5 në: Qendra e Botimeve Zyrtare. (2014, 8 gusht). Ligji nr. 70/2014 “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 124, 5709-5724. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2014/124/26d81959-6733-4bc3-b596-a73e1e87eca3>

8 Analiza e gjendjes në Policinë e Shtetit, Gardë dhe SHÇBA. (2017, tetor). Ministria e Brendshme, f. 3.

9 Për më shumë detaje: Erebara, Gj. (2016, 12 maj). Nga Shqipëria në Belgjikë, tonelatat e drogës shqiptare që “mbyten” Europën. Reporter.al. <https://www.reporter.al/nga-shqiperia-ne-belgjike-tonelatat-e-droges-shqiptare-qe-mbyten-europen/>; Arapi, L. (2017, 2 janar) Albania: Europe's cannabis paradise. Deutsche Welle. <https://www.dw.com/en/albania-europes-cannabis-paradise/a-36983338>; Luca, d. D. (2017, 23 tetor). Droga dall’Albania alla Sicilia, parla l’agente in esilio “Nel mio paese anche la polizia traffica la marijuana” [Droga nga Shqipëria në Sicili, flet agjenti në ekzil “Në vendin tim, edhe policia trafikon marjuanë”]. Meridionews – Edizione Catania. <https://catania.meridionews.it/articolo/59842/droga-dallalbania-alla-sicilia-parla-lagente-in-esilio-nel-mio-paese-anche-la-polizia-traffica-la-marijuana/>;

10 Analiza e gjendjes në Policinë e Shtetit, Gardë dhe SHÇBA. (2017, tetor). Ministria e Brendshme, f. 42-44.

11 Ekskluzive/ Vettingu në polici, si do të pastrohen uniformat blu nga krimi. (2018, 8 janar). Top Channel. <http://top-channel.tv/2018/01/08/vettingu-ne-polici-si-do-te-pastrohen-uniformat-blu-nga-krimi/>

12 Vetting në Polici: Guida e vlerësimit të punonjësve të PSH, GR, SHÇBA. (2018). Ministria e Brendshme, f. 4. [https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Guida\\_e\\_Vettingut.pdf](https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Guida_e_Vettingut.pdf)

13 Vetting në Polici: Guida e vlerësimit të punonjësve të PSH, GR, SHÇBA. Ministria e Brendshme, f. 4.

në Ndhimë të Policisë (ICITAP). Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” u miratua me shumicë të thjeshtë nga maxhoranca qeverisëse. Ai nuk përfshiu tërësisht në përmbajtjen e tij ndryshimet e propozuara nga opozita, ndaj dhe ajo në mënyrë të vazhdueshme e ka kundërshtuar procesin<sup>14</sup>. Edhe grupe të tjera të interesit, si p.sh. sindikata e punonjësve të policisë, raportojnë se nuk janë përfshirë dhe sugjerimet e tyre nuk janë marrë parasysh.

Pas miratimit, Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj e cilësoi vetingun si “një tjetër faqe të re (që) po hapet në reformimin e policisë, (të cilën) vettingu do ta ndryshojë rrënjësisht [...] (duke e bërë një) histori të një policie moderne evropiane.”<sup>15</sup> Atij iu atribua fuqia e çrënjësjes së mosintegritetit, mosprofesionalizmit, korrupsionit e kriminalizimit të policisë, që mbetet një pritshmëri e tepruar për një mekanizëm kontrolli, sado i strukturuar dhe i institucionalizuar qoftë ai. Adresimi i pazotësisë e kriminalitetit veç tek vullneti i kompromentuar i punonjësit në shërbim, i mundëson mekanizmit ta korrigjojë simptomën, por jo sëmundjen gjeneruese të saj.

## 2.2. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PËR ZBATIMIN E PROCESIT TË VETINGUT

### 2.2.1 Procesi i hartimit dhe miratimit të ligjit për vetingun në polici

Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së, në Ministrinë e Brendshme”<sup>16</sup>, hyri në fuqi më 4.4.2018. Sipas përcaktimeve të këtij ligji, në respekt të precedentit të vendosur nga legjislacioni për reformën në drejtësi, vlerësimi kalimtar i punonjësve të policisë do të kryhet bazuar në tre komponentë vlerësimi, përkatësisht: kontrolli i figurës, kontrolli dhe verifikimi i pasurisë, si edhe kontrolli e verifikimi i nivelit profesional sipas gradës, funksionit, llojit të detyrës, dhe përgjegjësive që ka çdo punonjës policie.<sup>17</sup> Procesi i vlerësimit do të kryhet me tri faza, sipas tipologjisë së gradave dhe funksioneve në këto tre institucione. Sistemi i gradave lejon ndarjen e subjekteve të vlerësimit në tre kategori kryesore: grada të larta, të mesme dhe të ulëta. Të gjithë punonjësit e policisë së strukturave të mësipërme do të jenë subjekt i vlerësimit të këtij ligji, me përjashtim të atyre që dorëhiqen brenda afateve të përcaktuara në të. Në variantin fillestar, procesi i vlerësimit do të kryhej nga organe të pavarura [Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit (KJV), Komisioni Qendror dhe ai Vendor], mënyra e ngritjes dhe funksionimi i të cilave përcaktohet në ligjin nr.

- ■
- 14 Deputetët e Opozitës nga Partia Demokratike propozuan 3 ndryshime thelbësore: 1. Ministri i Brendshëm, shefi i tij i kabinetit dhe zëvendësministri duhet të jenë subjekt i vetingut, njësoj si trupa e Policisë së Shtetit. 2. Organet e vetingut duhet të jenë jopolitike dhe jo nën varësinë e Ministrisë së Brendshme apo qeverisë. 3. Anëtarët e organeve të vetingut duhet të mos kenë ushtruar funksione politike për 5-10 vjet, nga vetëm 3 vjet që parashikohej në projektligj. Propozimet nuk u pranuan nga maxhoranca duke rrëzuar edhe alibinë e ngritur nga Ministri i Brendshëm se ishte i gatshëm që vetingu të niste prej tij. Për më shumë shihni: [http://www.time.al/18-03-06-Si-do-te-behet-vetingu-ne-polici-Hodaj-Propozimet-e-LSI-nuk-prekin-thelbin62544/Si-do-te-behet-vetingu-ne-polici-Hodaj-Propozimet-e-LSI-nuk-prekin-thelbin.aspx](http://fax.al/read/news/14481355/17291248/amendamentet-e-pd-per-vetingun-ne-polici-rrezohen-ne-komisionin-e-ligjeve-Grupi-parlamentar-i-LSI-se-paraqiti-rreth-19-ndryshime-ku-shumica-me-e-madhe-ishin-te-natyrës-se-teknikës-legjislative-Dy-ndryshimet-që-u-morën-parasysh-ishin-përfshirja-e-përfaqësuesve-të-Avokatit-të-Popullit-dhe-Shërbimit-Informativ-Shtetëror-në-përbërjen-e-Bordit-Përzgjedhës-dhe-krijimi-i-nënkomisionit-të-posaçëm-parlamentar-që-do-të-ndjekë-e-mbikqyrë-zbatimin-e-ligjit-Për-më-shumë-shihni:)
- 15 Vettingu në Polici, Xhafaj: Po hapet një faqe e re! Reformë! (2018, 26 shkurt). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/lajm/vettingu-n-euml-polici-xhafaj-po-br-hapet-nbsp-nj-euml-faqe-e-re-reform-euml-br?r=pop5s>
- 16 Qendra e Botimeve Zyrtare. (2018, 20 mars). Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA, në Ministrinë e Brendshme”. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 39, 2379-2435. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/39/e052fc58-ab5d-4f90-ae18-9cfcc907f678>
- 17 Vlerësimi profesional përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit me gradën dhe/ose pozicionin që mban, gjatë një kohëzgjatjeje jo më shumë se 7 vjet.

12/2018. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve, sipas këtij ligji, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat do t'i nënshtrohen vlerësimit periodik çdo 3 vjet, bazuar në analizën e riskut për struktura apo njësi të caktuara, si dhe në informacione apo të dhëna të ndryshme, konform nenit 65 të ligjit nr. 12/2018. Me përzgjedhjen e anëtarëve të KJV-së dhe sekretariatit teknik pranë këtij komisioni, procesi i vetingut në polici duhet të vijonte me verifikimin e gradave të larta të policisë.

Në vitin 2019, Ministria e Brendshme propozoi ndryshime në ligjin e vetingut në polici, që u miratuan me ligjin nr. 20/2019,<sup>18</sup> e që devijuan procesin e parashikuar fillimisht. Ligji nr. 20/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme" u shqyrtua me procedurë të përshpejtuar më 21.3.2019 në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, duke anashkuar procesin e konsultimit publik me grupet e interesit. Dy janë ndryshimet kryesore në ligjin e vetingut:

1) Ndryshimi i parë konsiston në shfuqizimin e Komisionit Qendror dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit, duke i zëvendësuar këto organe me institucionin e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Kjo strukturë përgjegjëse do të votojë të gjithë punonjësit e policisë në fazën e dytë dhe të tretë të vlerësimit, që janë rreth 12,000 në rang republike. Ndërkohë, KJV-ja do të vijojë punën për vlerësimin e punonjësve të policisë me grada të larta si dhe të të gjithë punonjësve të SHÇBA-së, në fazën e parë.

2) Ndryshimi i dytë përmban shfuqizimin e nenit 68 të ligjit 12/2018 të vetingut në polici. Ky nen parashikonte se procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të PSH-së, Gardës së Republikës

dhe SHÇBA-së do të përfundonte brenda një periudhe prej 24 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra brenda muajit prill 2020. Ministri i Brendshëm kërkoi në Komisionin Parlamentar për Sigurinë Kombëtare shtyrjen e afatit të vetingut në polici, duke qenë se afati i parashikuar fillimisht konsiderohej praktikisht i pamundur për t'u arritur. Por ndërkohë neni 13 i ligjit 20/2019 detyron përfundimin e ushtrimit të detyrës së KJV-së brenda qershorit 2020, kur parashkruhet edhe përfundimi i fazës së parë të vetingut. Ndërsa nuk parashikohet një afat tjetër kohor se kur mund të përfundojë vlerësimi i 12,000 punonjësve të Policisë së Shtetit, duke e lënë të papërcaktuar këtë çështje. Gjithashtu mospërcaktimi i qartë i afateve për zhvillimin e seancave dëgjimore për subjektet e vlerësimit, bën që procesi të përfundojë në afate kohore të paparashikuara.

Sipas relacionit shoqërues të projektligjit në fjalë, arsyet të cilat sollën domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve ligjore lidheshin me uljen e kostos financiare, pasi parashikimi fillestar prej 300 milionë lekësh ishte një barrë e konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Kostoja që dhe një nga shkaqet e evidentuara të bllokimit të vijueshmërisë së procesit për rreth 9 muaj. Përfshirja e SHÇBA-së në procesin e vetingut në fazën e dytë dhe të tretë të vlerësimit, është menduar se shkurton në mënyrë drastike shpenzimet, duke i kursyer buxhetit të shtetit rreth 260 milionë lekë dhe duke minimizuar kostot shtesë. Për më tepër, SHÇBA-ja ka në arkivat e saj materiale për efektivat e Gardës dhe Policisë së Shtetit, si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit. Ndaj përfshirja e këtij institucioni në këtë proces është vlerësuar nga Ministria e Brendshme si një ndërhyrje që siguron efektivitet të zbatimit të procesit në kosto dhe kohë. Për atë kohë sa procedurat dhe kriteret e vlerësimit nuk ndryshojnë, vlerësohet se përfshirja e SHÇBA-së nuk e dëmton pavarësinë dhe paanshmërinë e procesit.<sup>19</sup>

■ ■

18 Qendra e Botimeve Zyrtare. (2019, 21 maj). Ligji nr. 20/2019, datë 28.3.2019 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme". Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 73, 5439-5440. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/73/01116bd4-37b4-4826-9331-3f81e373a2bb>

19 Relacioni shoqërues i projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme". (2019). Ministria e Brendshme.

Ligji nr. 20/2019 i miratuar në Kuvend nuk u dekretua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me pretendimin se ndryshimet në ligjin organik nuk krijojnë garancinë e duhur që një proces kaq i rëndësishëm si vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës të mund të realizohet në kohën e duhur, me objektivitet dhe paanshmëri. Në deklaratën e përcjellë nga ky institucion<sup>20</sup> argumentohet se këto ndryshime ligjore krijojnë vakume jo të vogla për abuzim dhe përdorim të strukturës së SHÇBA-së, në varësi të Ministrisë së Brendshme, nga kontekstet apo për interesa të ngushta politike. Komisioni parlamentar për Sigurinë Kombëtare rrëzoi me shumicë votash dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11175, datë 19.4.2019 për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 20/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.”<sup>21</sup> Ndërkaq, mazhoranca e rrëzoi me 79 vota dekretin presidencial në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë dhe e miratoi ligjin nr. 20/2019 më datë 16.05.2019. Ai hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare nr. 73, datë 21.5.2019.

## 2.2.2 Kritikat për ndryshimet në ligjin e vetingut në polici

Ndryshimet e propozuara për ligjin e ndryshuar për vetingun në polici janë pritur me kritika nga institucionet vendore, partnerët ndërkombëtarë, opozita dhe organizata të shoqërisë civile. Një ndër kritikata kryesore lidhet me kapacitetin e SHÇBA-së për ta kryer vetingun, pasi supozohet se cenohet pavarësia, cilësia dhe shpejtësia e procesit dhe në tërësi besueshmëria e tij.<sup>22</sup> Mosfunksionimi i mekanizmave të kontrollit të pasurisë, integritetit e profesionalizmit në SHÇBA<sup>23</sup> që pikërisht argumenti i ndërmarrjes së vetingut në polici. Në këtë kuadër, Komiteti Shqiptar i Helsinkit vëren se zbatimi “i fazës së dytë dhe të tretë të procesit të vlerësimit nga SHÇBA-ja nuk është zgjidhja më e drejtë dhe më e përshtatshme, madje përbën regres në raport me standardet që parashikon legjislacioni ekzistues, në drejtim të respektimit të parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë së strukturave që do të kryejnë vetingun në polici.”<sup>24</sup>

Kritika e dytë, lidhet me faktin se SHÇBA-ja është strukturë e veçantë e Ministrisë së Brendshme, në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit të Brendshëm.<sup>25</sup> Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të PSH-së dhe strukturat vendore miratohen nga Ministri, me propozimin e drejtorit të SHÇBA-së. Ministri gëzon kompetencë për të përcaktuar përparësitë e veprimtarisë së



20 “Vettingu në polici”, Meta nuk dekreton ndryshimet për ligjin: Ja shkeljet. (2019, 19 prill). Noa. <https://noa.al/lajmi/2019/04/2048723.html>

21 Vendimi nr. 56/2019 “Për rrëzimin e dekretit nr. 11 175, datë 19.4.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 20/2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”. (2019). Kuvendi i Shqipërisë. <https://www.parlament.al/Files/Akte/20190520134347vendim%20nr.%2056,%20dt.%2016.5.2019.pdf>

22 Ligji për vettingun në polici, Xhafaj skeptik për ndryshimet. (2019, 28 mars). BalkanWeb. <https://www.balkanweb.com/ligji-per-vettingun-ne-polici-xhafaj-skeptik-per-ndryshimet/>

23 Analiza e MB-së vë në pah se në bazë të ligjit 70/2014 për SHÇBA-në “SHÇBA ka potencialisht tagrin për verifikimin e pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime, por në realitet nuk ka të dhëna për verifikime të tilla specifike të kryera për punonjës të këtyre tre organeve (PSH, Gardë, SHÇBA)” [...] “Mekanizmat e kontrollit dhe vlerësimit nuk janë në gjendje të sigurojnë një kontroll objektiv, të paanshëm dhe të saktë të figurës, pasurive apo profesionalizmit të këtyre punonjësve”, në Ministria e Brendshme. Analiza e gjendjes në Policinë e Shtetit, Gardë dhe SHÇBA, f. 42; 4.

24 Nis Vettingu në polici/ SHÇBA dhe Garda marrin 45 dosjet e para. (2019, 30 maj). Gazeta Shqiptare. <http://gazetashqiptare.al/2019/05/30/nis-vettingu-ne-polici-shcba-dhe-garda-marrin-45-dosjet-e-para/>

25 Neni 8 në Qendra e Botimeve Zyrtare. (2014, 8 gusht). Ligji nr. 70/2014, datë 10.7.2014 “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 124, 5709-5724. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2014/124/26d81959-6733-4bc3-b596-a73e1e87eca3>

shërbimit, si dhe nxjerr urdhra dhe udhëzime në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit.<sup>26</sup> Shqetësimin e ndan dhe Transparency International, e cila raporton se pavarësia e SHÇBA-së është e vështirë për t'u provuar, duke qenë se kryetari i saj ndryshon sa herë që ndryshon edhe Ministri i Brendshëm.<sup>27</sup>

Kritika e tretë, lidhet me argumentin e moskonsultimit publik të ligjit nr. 20/2019 të vetingut në polici, me grupet e interesit si dhe me organizatat partnere ndërkombëtare, si misioni PAMECA dhe ICITAP, të cilat kanë qenë aktive dhe kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin e ligjit organik nr. 12/2018.<sup>28</sup> Ndryshimi i shpejtë i ligjit brenda një viti nga hyrja në fuqi dhe mosparashikimi as i situatave problematike që e pasrendën (mospërafrimi i legjislacionit me afatet kohore të institucioneve të tjera që japin informacion për dosjet e subjekteve sipas ligjeve të tyre organike; mosparashikimi i implikimeve të ndryshimit të vendeve të punës gjatë kohëzgjatjes së procesit), vë në pah rëndësinë e konsultimit publik me palët e interesuara.

Një tjetër kritikë lidhet me heqjen tërësore të afatit se kur përfundon procesi i vlerësimit kalimtar. Mospërcaktimi i afatit mund të krijojë gjendje pasigurie të tejzgjatur për çdo punonjës subjekt i ligjit, si dhe mund të sjellë rrezikun e ndikimit dhe presionit të vazhduar ndaj veprimtarisë së përditshme të forcave policore. Nga ana tjetër, mungesa e afatit të përgjithshëm ligjor për përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar, mund ta zgjasë kohën e qëndrimit brenda forcave policore të individëve që nuk e meritojnë

të jenë pjesë e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës dhe që, për shkak të profilit të tyre, janë lehtësisht të shantazhueshëm.<sup>29</sup>

Kritika e fundit lidhet me shpenzimet infrastrukturore dhe logjistike që janë bërë tashmë nga Ministria e Brendshme në kuadër të plotësimit të nevojave të punës së organeve të zgjeruara të vetingut, sipas skemës së parë të vlerësimit me 3 komisione vlerësimi dhe po aq sekretariate teknike, me një total prej 135 punonjësish. Dëmi i mundshëm ekonomik i identifikimit të godinës, ndërmarrjes së projekteve teknike të ristrukturimit e rehabilitimit, prokurimi dhe zbatimi i projekteve për ristrukturimin e saj konform kapaciteteve të modelit që u ndryshua me ligj<sup>30</sup>, mbetet i pazhbëshëm e mund të ishte shmangur. Nuk ka një parashikim nëse këto burime do t'i shërbejnë strukturës së SHÇBA-së për të përfunduar procesin.

### 2.2.3 Kuadri rregullator për zbatimin e vetingut në polici

Në përputhje me nenin 29 të ligjit të vetingut në polici, trajtimi financiar për anëtarët e Bordit Përzgjedhës (BP), anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, si dhe anëtarët e sekretariateve teknike, përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Çështja financiare ka qenë edhe një prej arsyeve për vonesat e procesit të vetingut, si edhe të dorëheqjeve nga anëtarësia në KJV dhe sekretariatit teknik. VKM-ja për trajtimin financiar të anëtarëve është miratuar afërsisht 8 muaj me vonesë<sup>31</sup> nga afati prej një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit, i parashikuar fillimisht në ligj.

■ ■

26 Vettingu në polici, ndryshimet në ligj përplasnin në Kuvend Xhafaj-Lleshaj. (2019, 28 mars). Top Channel. <http://top-channel.tv/2019/03/28/vettingu-ne-polici-ndryshimet-ne-ligj-perplasin-ne-kuvend-xhafaj-lleshaj/>

27 Halo, A. dhe Llubani, M. (2016). National Integrity System Assessment Albania 2016. Transparency International, f. 115. [https://images.transparencycdn.org/images/2016\\_NISAlbania\\_EN.pdf](https://images.transparencycdn.org/images/2016_NISAlbania_EN.pdf)

28 "Vettingu në polici", Meta nuk dekreton ndryshimet për ligjin: Ja shkeljet. Noa.

29 "Vettingu në polici", Meta nuk dekreton ndryshimet për ligjin: Ja shkeljet. Noa.

30 Sipas deklaramit të zv. Ministri i Punëve të Brendshme Julian Hoda, në Procesverbalin e Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 1 tetor). Kuvendi i Shqipërisë, f. 4. <https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20190206120619Procesverbal%20i%20Vetingut%20p%C3%ABr%20policin%C3%AB%20dat%C3%AB%2001.10.2018.pdf>

31 Vendimi nr. 14, datë 16.1.2019 " Për trajtimin financiar të anëtarëve të Bordit të Përzgjedhjes, të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kalimtar të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme dhe të Sekretariatit teknik pranë këtij komisioni", përcakton buxhetin e akorduar për burimet njerëzore të anëtarëve të KJV-së .

Rregullorja “Për veprimtarinë dhe mënyrën e funksionimit të KJV-së dhe Sekretariatit Teknik” miratuar me vendimin nr. 25/1, datë 18.9.2019 të KJV-së, përcakton: rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së organeve të vlerësimit; rregullat e organizimit të punës për sekretariatit teknik; rregullat mbi mënyrën e komunikimit dhe ndërveprimit me strukturat mbështetëse të procesit, si edhe rregullat mbi bashkëpunimin, ndërveprimin, informimin dhe njoftimin e palëve të treta gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit kalimtar të subjekteve. Rregullorja është publikuar në faqen zyrtare të KJV-së.<sup>32</sup> Sipas parashikimeve të saj, e drejta e informimit garantohet në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe pas mendimit me shkrim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregullore, raporti i relatorit, projektvendimi, çdo informacion për diskutimin dhe për votimin e trupës, shënimet e trupës së anëtarëve gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit të rastit, mendimet e anëtarëve të Sekretarit Teknik si edhe çdo material tjetër i përcaktuar nga mbledhja e anëtarëve të Komisionit duhet të jenë konfidencialë dhe nuk duhet të jenë të aksesueshëm as nga palët e as nga publiku. Në nenin 6 dhe 26 të kësaj rregulloreje përcaktohet nxjerrja e rregullave të hollësishme për administrimin e dokumentacionit dhe/ose të dhënat për të cilat palëve u kufizohet e drejta e njohjes së një rregulloreje të posaçme të miratuar nga mbledhja e KJV-së, pas marrjes së udhëzimeve edhe nga organet përkatëse ligjzbatuese. Aktualisht, nuk rezulton një rregullore e miratuar nga KJV-ja për këtë qëllim.

Rregullorja për procedurat e zhvillimit të shortit, e miratuar me vendimin nr. 25, datë 18.9.2019 të Mbledhjes së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, parashikon: procedurat e shortit për ndarjen e trupave të vlerësimit; procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues; procedurat e

shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa vlerësuese; caktimin e anëtarit relator dhe kryesuesit të seancës; dhe procedurat e shortit për caktimin e një anëtarit të sekretariatit teknik për çdo anëtar të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Kjo rregullore nuk është publikuar në faqen zyrtare të KJV-së.

Rregullorja “Për unifikimin e hapave procedurale gjatë vlerësimit të subjekteve nga trupa e vlerësimit”, e miratuar me vendimin nr. 17, datë 31.5.2019 të KJV-së, parashikon rregulla për procedurën standarde të vlerësimit të trupave vlerësuese (nga faza e hetimit deri tek përfundimi i procesit të vlerësimit të subjekteve), dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të KJV-së. Kjo rregullore përfshin hapat proceduralë të detajuara për procesin e vlerësimit të subjekteve që janë dhe objekti i punës dhe veprimtarisë së KJV-së. Në këtë kuadër, parashikimet e saj mund të jenë pjesë e rregullores “Për veprimtarinë dhe mënyrën e funksionimit të KJV-së dhe Sekretariatit Teknik” dhe jo një akt rregullator më vete. Ligji nr. 12/2018 nuk parashikon nxjerrjen e një rregulloreje me objekt unifikimin e hapave proceduralë gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve të vlerësimit kalimtar.

KJV-ja me vendimin nr. 116, datë 6.11.2019, “Për unifikimin e trajtimit të rasteve të dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit kalimtar sipas Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, gjatë fazës së hetimit administrativ nga Trupat Vlerësuese të KJV”, ka përcaktuar rregullat për unifikimin e trajtimit të subjekteve të dorëhequra gjatë fazës së hetimit administrativ. Vendimi është publikuar në faqen zyrtare të KJV-së.<sup>33</sup> Ligji nr. 12/2018 i ndryshuar, neni 57, paragrafi 1, u jep të drejtë subjekteve të vetingut të tërhiqen nga detyra jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit. Vendimi unifikues ka për qëllim të rregullojë praktikën e dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit gjatë fazës së hetimit administrativ, të shoqëruara me aktin e lirimit të institucionit përgjegjës. Sipas përcaktimeve të tij, subjektet e dorëhequra përtej afatit të përcaktuar në ligj trajtohen njëjloj me ato që kanë dhënë

■ ■

32 Rregullorja “Për veprimtarinë dhe mënyrën e funksionimit të KJV-së dhe Sekretariatit Teknik”. (2019, 18 shtator, Vendimi nr. 25/1). Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. <http://kju.al/wp-content/uploads/2019/07/Rregullore-KJV.pdf>

33 Vendimi nr. 116, datë 6.11.2019 “Për unifikimin e trajtimit të rasteve të dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit kalimtar sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar, gjatë fazës së hetimit administrativ nga Trupat Vlerësuese të KJV”. (2019). Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. <http://kju.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-p%C3%ABr-rastet-e-dor%C3%ABheqjeve.pdf>

dorëheqjen brenda afatit të përcaktuar në të, duke i përjashtuar nga procesi i vetingut. Ligji për vlerësimin kalimtar në polici nuk parashikon në asnjë dispozitë të tij nxjerrjen e një akti të tillë nga ana e KJV-së.

Me vendimin nr. 22, datë 3.9.2019, KJV-ja ka miratuar “Rregulloren për median”, e cila është e publikuar në faqen zyrtare të saj.<sup>34</sup> Kjo rregullore ka për qëllim të informojë gazetarët në lidhje me bashkëpunimin që ata mund të presin nga ana e KJV-së, duke mundësuar transparencën e procesit dhe duke ruajtur njëkohësisht privatësinë e subjekteve të rivlerësimit. Rregullorja përcakton gjithashtu rregullat të cilat mundësojnë ruajtjen e rendit në selinë e institucionit dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore. Ajo ofron informacion në lidhje me: komunikimin e KJV-së me median; çfarë duhet të publikohet në faqen zyrtare të KJV-së mbi procesin e vlerësimit kalimtar; informacionin teknik që iu ofrohet mediave për seancat dëgjimore, para dhe pas zhvillimit të tyre, ku përfshihet njohja me vendimet e KJV-së; si dhe rregullat që duhet të respektohen nga gazetarët dhe publiku gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

KJV-ja raporton se nuk ka marrë mbështetje dhe ekspertizë në procesin e hartimit të kuadrit të brendshëm rregullativ, procedurave të komunikimit me publikun apo institucionet mbështetëse, pavarësisht se ia ka kërkuar MB-së. Mungesa e fondeve buxhetore ka kufizuar marrjen e asistencës teknike dhe ekspertizës. KJV-ja nuk

raporton ta ketë shoqëruar procesin e hartimit të akteve rregullatore me procese konsultuese me grupet e interesit, si p.sh. përfaqësues të subjekteve të vlerësimit (sindikata e punonjësve të PSH-së), ekspertë apo partnerët ndërkombëtarë.

#### **2.2.4 Gjithëpërfshirja dhe transparenca në hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullator**

IDM-ja arriti të intervistojë 12 përfaqësues të autoriteteve (KJV, Sekretariati Teknik dhe SHÇBA) subjekteve të vlerësimit, grupeve të interesit dhe mediave të cilët u pyetën në lidhje me aspekte të gjithëpërfshirjes dhe transparencës në hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik në PSH, Gardë dhe SHÇBA (referoju shtojcës nr. 3). Të intervistuarit u shprehën mbi procesin e hartimit të ligjit e akteve nënligjore dhe ato administrative të nxjerra nga KJV. Asnjë prej tyre nuk vlerëson se kuadri ligjor ka qenë faktor ndikues në ecurinë e ngadaltë të procesit. Aktorët gjykojnë se janë përfshirë në procesin e hartimit të ligjit apo akteve të tjera nënligjore, por në mënyrë të moderuar. Ka pasur më shumë përfshirje dhe diskutim në fillimet e procesit, në hartimin e projektligjit, ndërkohë që në ndryshimet e mëvonshme të ligjit nuk ka pasur konsultim.

■ ■  
34 Rregullore për mediat. (2019, 3 shtator, Vendimi nr. 22). Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. <http://kju.al/wp-content/uploads/2020/02/Rregullore-p%C3%ABr-Mediat-1.pdf>



**Tabela 1: Përmbledhje e vlerësimit të rezultateve të intervistave mbi kuadrin**

	<b>NUMRI I SEANCAVE KONSULTUESE</b>	<b>NUMRI I AKTEVE LIGJORE TË MIRATUARA</b>	<b>AKTE NËNLIGJORE</b>	<b>NUMRI I AKTEVE ADMINISTRATIVE</b>
<b>OUTPUT-E TË REFORMËS</b>	4	2	1	5
<b>KONSULTIMI/PËRFSHIRJA DHE TRANSPARENCA</b>	Moderuar	Moderuar	Moderuar	Moderuar
<b>PËRSHTATSHMËRIA DHE MJAFTUESHMËRIA</b>	Ulët	Moderuar	Moderuar	Moderuar
<b>NEVOJA PËR NDRYSHIM/PËRSHTATJE</b>	E Lartë	E ulët	E moderuar	E ulët

*Burimi: Intervistat e thelluara, burime administrative dhe vlerësime të autorëve*

Përfaqësuesi i Sindikatës së Policisë, punonjësit e policisë që janë subjekt vlerësimi dhe gazetari, përfaqësues i medias i cili e ka ndjekur procesin nga fillimi, mendojnë se sugjerimet e dërguara nuk kanë gjetur pasqyrim të plotë në ligj, apo dhe në procedurat e zbatuara. Nevoja për të përshpejtuar procesin lidhet me çështje të zbatimit të ligjit, forcimit të institucioneve, çështje të përmirësimit të kapaciteteve administruese dhe menaxhuese të procesit dhe dokumentacionit. Të njëjtët të intervistuar kërkojnë gjithashtu sigurimin e paanshmërisë dhe besueshmërisë së procesit duke bërë ndryshime ligjore që i bëjnë KJV-në, ose SHÇBA-në më të pavarura.

## **2.3 KUADRI INSTITUCIONAL I PROCESIT TË VETTINGUT**

### **2.3.1 Ngritja dhe funksionimi i Bordit Përzgjedhës**

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 12/2018 të vettingut në polici, të ndryshuar, është ngritur Bordi i

Përzgjedhjes (BP), i cili ka për detyrë përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të sekretariatit teknik pranë këtij komisioni. Ai përbëhet nga 5 anëtarë<sup>35</sup>, të cilët caktohen nga titullarët e institucioneve përkatëse nga radhët e nëpunësve të nivelit të lartë. Kriteret e përzgjedhjes së tyre, të përcaktuara në nenin 8 të të njëjtit ligj, lidhen me profesionalizmin, përvojën dhe integritetin e figurës.

Mbledhja e parë e BP-së u mbajt më 26.4.2018. Gjatë veprimtarisë së tij, BP-ja është marrë me procedurat e ndërtimit të organeve të KJV-së dhe sekretariatit të saj teknik, si dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme. Në kuadër të formimit të KJV-së janë realizuar këto procedura: procedura e përcaktimit të anëtarëve në bashkëpunim me ILDKPKI-në dhe rektoratin e Universitetit të Tiranës, siç parashihet në ligj; procedura për hapjen e aplikimeve për anëtarët e jashtëm të KJV-së dhe sekretariatit teknik, në të cilën u tejkaluan afatet ligjore; shqyrtimi i dosjeve të aplikuesve, vlerësimi i tyre, shpallja e listës së kandidatëve

■ ■

35 Bordi i Përzgjedhjes përbëhet nga 5 anëtarë: a) një anëtar nga Ministria e Brendshme, i cili drejton bordin; b) një anëtar nga Avokati i Popullit; c) një anëtar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; ç) një anëtar nga Shërbimi Informativ Shtetëror; d) një anëtar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

që përmbushën kriteret për intervistim, të cilat u bënë gjithashtu në tejkalim të afateve ligjore; intervistimi i kandidatëve që kaluan në fazën e dytë të aplikimit<sup>36</sup>, njoftimi i fituesve dhe publikimi i listës së anëtarëve finalë të KJV-së e sekretarit teknik etj. Bordi i Përzgjedhjes nuk ka nxjerrë dhe bërë publike aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Vonesat e procesit lidhen fillimisht me konstituimin e vonë të vetë BP-së, 20 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit, ndërkohë që vetë ligji detyron publikimin e thirrjes për kandidatët anëtarë të KJV-së brenda 10 ditëve pas hyrjes në fuqi të tij, sipas nenit 11, pika 1. Më tej, arsyeja vendimtare e vonesës u shkaktua nga procedura ndërinstucionale për vendosjen dhe përllogaritjen e pagave të organeve të vetingut, që u përfundua me nxjerrjen e VKM-së nr. 14, datë 16.1.2019, për trajtimin financiar të punonjësve në organet e vlerësimit kalimtar, afro 8 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, nga 1 muaj që ishte afati ligjor. Mospërcaktimi në kohë i kriterit të pagës shkaktoi paqëndrueshmëri të listës së aplikuesve fitues, të cilët nuk qenë të gatshëm të ndryshojnë punëdhënësit e tyre, pa ditur efektin financiar të vendimit. Çështja u problematizua nga përfaqësuesja e Bordit Përzgjedhës gjatë 2 seancave të nënkomisionit parlamentar përkatës, e cila theksoi se shqetësimi ndahej edhe nga partnerët<sup>37</sup>. Situata e krijuar tregoi se, ndryshe nga ç'ishte rekomanduar nga grupi i punës në MB që kërkoi analizë të thellë e deri në detaje të mënyrave të ndërhyrjes në strukturat e policisë<sup>38</sup> e pavarësisht "parashikimit deri-diku të skemës financiare në relacionin e projektligjit për vetingun në polici"<sup>39</sup>, projekti në fjalë nuk është pararendur nga një analizë e mirëfilltë e kostove buxhetore.

### 2.3.2 Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit është një organ i ngritur në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.12/2018 për vetingun në polici dhe është përgjegjës për fazën e parë të vlerësimit kalimtar të subjekteve të parashikuara<sup>40</sup> në nenin 6 të këtij ligji. Ai ka në përbërjen e tij 15 anëtarë, nga të cilët: a) 5 anëtarë (+2 anëtarë zëvendësues) caktohen nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të përzgjedhur ndërmjet punonjësve të këtij institucioni, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj; b) 10 anëtarë përzgjidhen nga Bordi Përzgjedhës (5 pedagogë të Universitetit të Tiranës dhe 5 anëtarë me konkurrim të hapur), sipas kriterëve të parashikuara në ligj. KJV-ja mbështetet nga një sekretariat teknik i përbërë nga 15 punonjës, të cilët gjithashtu përzgjidhen me procedurë të hapur konkurrimi nga Bordi i Përzgjedhjes, në mënyrë transparente, sipas të njëjtave modalitete të aplikuara për anëtarët e KJV-së dhe kriterëve të përcaktuara në ligj.

Procedurat e konkurrimit për përzgjedhjen e 5 anëtarëve të KJV-së dhe 15 anëtarëve të Sekretariatit teknik pranë KJV-së filluan në prill 2018 sipas fazave si më poshtë:

- Faza 1: më 27.4.2018 u botua thirrja publike për shprehjen e interesit për aplikime në organet e KJV-së dhe sekretariatit teknik.
- Faza 2: më 4.6.2018 u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme lista e 52 aplikuesve në konkurrim për vendet e lira në KJV dhe lista e 54 aplikantëve për anëtarë të sekretariatit

■ ■

36 Sipas raportimit të znj. Aida Shehi, anëtare e Bordit të Përzgjedhjes në Procesverbalin e Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 1 tetor). Kuvendi i Shqipërisë, f. 6-10.

37 Raportimi i znj. Aida Shehi në Procesverbalin e Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 1 tetor). Kuvendi i Shqipërisë, f. 10.

38 Analiza e gjendjes në Policinë e Shtetit, Gardë dhe SHÇBA. Ministria e Brendshme, f. 44.

39 Zv. Ministri i Punëve të Brendshme Julian Hoda, në Procesverbalin e Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 1 tetor). Kuvendi i Shqipërisë, f. 5.

40 KJV-ja vlerëson punonjësit në pozicionet ose me gradat e mëposhtme: a) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor e zëvendësdrejtor vendor dhe shef komisarati në Policinë e Shtetit; b) komandant e zëvendëskomandant, si dhe çdo oficer me gradë major, nënkolonel dhe kolonel në Gardën e Republikës; c) Punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

teknik. Aplikimet iu paraqitën dhe u shqyrtuan nga Bordi Përzgjedhës, konform kriterëve të parashikuara në nenet 10 dhe 12 të ligjit nr.12/2018.

- Faza 3: më 18.6.2018, në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme u botua lista e kandidatëve që përmbushën kriteret për kalim në fazën e dytë të intervistimit. Bordi i Përzgjedhjes njoftoi se të kualifikuarit për vijimin e konkurrimit qenë 38/52 aplikues për vendet vakante të KJV-së dhe 42/54 kandidatë për sekretariatit teknik.
- Faza 4: më 20.6.2018, Bordi Përzgjedhës listoi pikët finale të kandidatëve për vakancat në të dyja organet.
- Faza 5: më 11.2.2019, 7 muaj pas listimit të pikëve, Ministria e Brendshme publikoi në faqen zyrtare listën finale të anëtarëve të përzgjedhur në organet e vetingut.

Sipas afateve ligjore, kohëzgjatja e të gjithë procesit të aplikimit është 32 ditë, ndërsa faktikisht ai zgjati rreth 11 muaj. Për pasojë, edhe fillimi faktik i procesit të vlerësimit kalimtar që parashihej të niste në shtator 2018, u shty.

KJV-ja e filloi punën në shkurt 2019 dhe sipas ligjit 12/2018, të ndryshuar, neni 6, ajo e ushtron veprimtarinë e saj deri në qershor 2020, me përfundimin e procesit të vlerësimit të fazës së parë. Veprimtaria, mënyra e funksionimit të tij dhe sekretariati teknik rregullohen në rregulloren brendshme të KJV-së të shpjeguar më lart. Ajo organizohet në 5 trupa vlerësimi me 3 anëtarë secila, të cilët caktohen me short. Trupat e vlerësimit operojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe janë përgjegjëse për verifikimin, vlerësimin, si edhe për marrjen e vendimeve ndaj punonjësve në vetim. Mënyra e organizimit të trupave vlerësuese parashikohet në kreun III të rregullores.<sup>41</sup> Çështjet u shpërndahen trupave vlerësuese përmes procedurës së shortit, e rregulluar gjithashtu me rregulloren përkatëse.

Në këtë kuadër, sekretariati teknik përbën bërthamën ndihmëse, këshillimore dhe mbështet punën profesionale të anëtarëve të KJV-së. Me kërkesë të kryetarit të KJV-së, ai bën verifikime dhe kërkime ligjore, financiare etj., si dhe përgatit studime e analiza me shkrim për problematika të karakterit procedural dhe material, në lidhje me dosjen e vlerësimit.

Ndërkohë, burimet financiare që mbështesin operacionet e vetingut, me përjashtim të pagesave të anëtarëve të KJV-së, nuk rezultojnë të detajuara në buxhetin e Ministrisë së Brendshme. Paqartësia e skemave të financimit dhe burimeve financiare që mbështesin strukturat e vetingut, e bën të vështirë gjykimin e kapaciteteve dhe pavarësinë e KJV-së, e cila duhet të kërkojë mbështetje logjistike dhe financiare në strukturat administrative të MB-së për secilin aktivitet që ndërmerr. Kjo e ngadalëson aktivitetin duke ndikuar ndjeshëm në efikasitetin e procesit.

### 2.3.3 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si organ i vlerësimit

Ligji nr.12/2018 parashihte ngritjen e organeve të Komisionit Qendror të Vlerësimit e sekretariatit të tij teknik dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit e sekretariatit të tij teknik që do të zbatonin fazën e dytë dhe të tretë të vetingut. Meqenëse procesi vazhdon të jetë në fazën e tij të parë e për shkak të ndryshimeve ligjore përmes ligjit nr. 20/2019, këto organe nuk do të jenë më pjesë e procesit të vlerësimit kalimtar të policisë. Funksionet dhe detyrimet e tyre iu kaluan Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Kontrolli i trefishtë i integritetit, pasurisë dhe profesionalizmit të punonjësve të strukturave policore ka qenë prej vitesh në fokusin e veprimtarisë së institucionit, por përfshirja në ligjin 12/2018, i ndryshuar, e bën atë nominalisht një organ vlerësimi kalimtar dhe periodik. SHÇBA-ja do të vlerësojë të gjithë punonjësit e tjerë të Policisë së Shtetit dhe Gradës së Republikës, të cilët nuk janë subjekt vlerësimi i KJV-së. Numërohen në total rreth 12,000 punonjës të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës që janë pjesë e fazës së dytë të vlerësimit, të

41 Për më shumë, shihni: Rregullorja "Për veprimtarinë dhe mënyrën e funksionimit të KJV-së dhe Sekretariatit Teknik". Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

përcaktuar nga neni 6, pika 2 e ligjit 12/2018, i ndryshuar. Kritikën ndaj këtij ndryshimi ligjor u shpjeguan më lart, por implikimet e zbatimit të tij mbeten për t'u vëzhguar.

Nga të dhënat e mbledhura gjatë intervistimit raportohet se aktualisht SHÇBA-ja ka ngritur një strukturë të brendshme me 45 persona, të cilët janë duke u trajnuar në lidhje me procedurat e vetingut. SHÇBA-ja do të kryejë procesin e vlerësimit të komponentëve të pastërtisë së figurës, vlerësimin e aftësive profesionale dhe atë të pasurisë. SHÇBA-ja ka përvojë në kryerjen e vlerësimit për të dy kriteret e para. Përfaqësues të saj raportojnë se disponojnë të gjithë informacionin e duhur për vlerësimin e pastërtisë së figurës dhe aftësive profesionale në databazën e tyre të informacionit. Vështirësia më e madhe për këtë strukturë mbetet vlerësimi dhe verifikimi i pasurisë, të cilat edhe pse janë pjesë e objektit të veprimtarisë së Shërbimit sipas nenit 5, pika ç e ligjit nr. 70/2014, nuk janë veprimtari të lëvruara gjatë punës së tij. Megjithatë, për t'i paraprirë vështirësive, SHÇBA-ja është duke i trajnuar punonjësit në lidhje me vlerësimin financiar.

### **2.3.4 Ngritja dhe funksionimi i Nënkomisionit Parlamentar “Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut”**

Nënkomisioni për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për vetingun në polici u miratua më 19.7.2018, me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 87/2018, dhe filloi punën më 21.9.2018. Për shkak të kundërshtimit të ligjit<sup>42</sup> për vlerësimin kalimtar në polici, grupet parlamentare opozitare refuzuan të propozojnë anëtarët e tyre në këtë nënkomision. Duke qenë se palët e nënkomisionit ndahen në raportin 4:3 mes pozitës e opozitës, kuorumi për funksionimin e tij arrihej qoftë edhe veç me pjesëmarrjen e pozitës parlamentare.<sup>43</sup> Ndryshimi i përbërjes së

Kuvendit të Shqipërisë gjatë pranverës së 2019-s, mundësoi edhe plotësimin e vendeve vakante dhe funksionimin normal procedural të nënkomisionit.

Ai përbëhet nga 7 anëtarë që përfaqësojnë grupet parametare ekzistuese në Kuvendin e Shqipërisë. Nënkomisioni u konstituua më 21.9.2018 dhe ka zhvilluar 5 mbledhje gjatë periudhës së monitorimit.<sup>44</sup> Rendi i ditës së mbledhjeve ka qenë kryesisht: “vijueshmëria e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së”; të raportuarit mbi veprimtarinë e organeve të vetingut (Bordi i Përzgjedhjes i KJV-së, Sekretariati Teknik i KJV-së); dhe, së fundmi, u krye një vizitë në ambientet e KJV-së, ku u pa nga afër procesi dhe u shqyrtuan problematikat e hasura deri atëherë. Ky nënkomision nuk rezultoi të ketë publikuar ndonjë raport pune apo monitorimi mbi procesin e vetingut në polici.

■ ■

42 Dedaj, E. (2018, 20 shkurt). Ministri Xhafaj nuk do i nënshtrohet vettingut, ligji kalon në komision me votat e PS. Ora News. <https://www.oranews.tv/article/vettingu-alibeaj-pasagjeret-e-003gb-nuk-mund-te-vleresojne-policine>

43 Shih Procesverbalin e Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 21 shtator). Kuvendi i Shqipërisë, f. 3. <https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20181001135602Procesverbal%20Nenkomisioni%20vetingut%20dat%C3%AB%2021.09.2018.pdf>

44 Mbledhjet janë mbajtur në datat: 21 shtator 2018, pa opozitën; 1 tetor 2018 – brenda muajit; 6 shkurt 2019 – pas 4 muajsh; 13 shtator 2019 – pas 7 muajsh, me opozitën; 24 janar 2020 – pas 4 muajsh.

# III. ASPEKTE DHE SFIDA TË ZBATIMIT TË VETINGUT NË POLICINË E SHETIT

## 3.1 SKEMA FILLESTARE E VLERËSIMIT TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, GARDËS DHE SHÇBA-SË SIPAS LIGJIT NR. 12/2018 TË VETINGUT NË POLICI

Sipas përcaktimeve të ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së, në Ministrinë e Brendshme”, vlerësimi kalimtar i

punonjësve parashikohej të realizohej në 3 faza, sipas tipologjisë së gradave dhe funksioneve në këto tre institucione. Sistemi i gradave lejon ndarjen në tri kategori kryesore: grada të larta (245 punonjës), të mesme (2,700 punonjës) dhe të nivelit bazë (9,000). Fazat e vlerësimit vijojnë si më poshtë (për referim figura nr.1).

Tabelë 2: Fazat e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së


FAZAT	KOMISIONI	SUBJEKT I VLERËSIMIT
<b>FAZA E PARË:</b>	Vlerësimi parashikohej të kryhej nga 15 anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, të cilët do të asistoheshin nga një sekretariat teknik, i përbërë nga 15 punonjës.	KJV-ja parashikonte të vlerësonte 245 punonjësit që mbanin grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.
<b>FAZA E DYTË</b>	Vlerësimi parashikohej të kryhej nga Komisioni Qendror i Vlerësimit (KQV), i përbërë nga 45 anëtarë, 15 prej të cilëve janë anëtarët e zgjedhur në KJV, ndërsa 30 anëtarët e tjerë do të përzgjidheshin nga KJV-ja midis punonjësve me grada të larta që kanë kaluar me sukses procesin e tyre të vlerësimit, në fazën e parë. Ndër 30 anëtarët që do të zgjidheshin nga KJV-ja, 20 anëtarë do të ishin nga Policia e Shtetit, 6 anëtarë nga Garda e RSH-së dhe 4 anëtarë nga SHÇBA-ja, kjo në përpjesëtim me numrin e përgjithshëm të punonjësve të secilës strukturë.	KQV-ja parashikonte të vlerësonte 2,700 punonjës që mbanin gradat e nivelit të mesëm drejtues.

<b>FAZA E TRETË:</b>	<p>Vlerësimi parashikohej të kryhej nga Komisioni Vendor i Vlerësimit (KVV) i përbërë nga 135 anëtarë (45 anëtarët e KQV do të ishin automatikisht anëtarë të KVV-së si dhe 90 anëtarët e tjerë zgjidhen nga KQV-ja nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit dhe Gardës së Republikës që kanë kaluar me sukses procesin e tyre të vlerësimit) të asistuar nga sekretariati teknik përkatës.</p>	<p>KQV-ja parashikonte të vlerësonte rreth 9,000 punonjës të nivelit bazë të strukturave.</p>
----------------------	---	---

Figura nr.1

## GRADA E LARTË

Faza 1




## GRADA E MESME

Faza 2



## GRADA E BAZË

Faza 3



### 3.2 Skema aktuale e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së sipas ligjit nr. 20/2019 të vetingut në polici


**Faza e parë:** vlerësimi kalimtar kryhet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit i asistuar nga sekretariati teknik. KJV-ja vlerëson punonjësit me grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, përkatësisht 245 punonjës. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit

organizohet në 5 trupa vlerësimi me nga 3 anëtarë secila, dhe mbështetet nga një sekretariat teknik, i përbërë nga 15 punonjës, me 3 punonjës për secilën trupë vlerësimi.


**Faza e dytë:** punonjësit e SHÇBA-së që e kanë kaluar me sukses vetingun gjatë fazës së parë të vlerësimit, do të vlerësojnë rreth 12,000 punonjës të policisë që mbajnë gradat e nivelit të mesëm drejtues dhe punonjësit e nivelit bazë të strukturave.

Figura nr.2

#### FAZA 1



#### FAZA 2



### 3.3 OBJEKTI I VLERËSIMIT SIPAS LIGJIT NR. 12/2018 I VETINGUT NË POLICI, I NDRYSHUAR

#### Kontrolli i figurës (neni 35)

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të tjera për pastërtinë e figurës, me qëllim identifikimin e atyre që janë të përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale. Organet e vlerësimit verifikojnë dokumentacionin e informacionin

nga institucione të ndryshme, provat, kallëzimet, ankesat nga komuniteti, të cilat janë të provuara dhe vërtetuara. Ky lloj vlerësimi nuk ka përcaktime të periudhës në shyrtime, pasi integriteti si i tillë nuk mund të kufizohet në kohë.

#### Kontrolli dhe verifikimi i pasurisë (neni 31 dhe 32)

Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private të punonjësit dhe personat e lidhur me të. Punonjësi

deklaron çdo pasuri, të luajshme apo të paluajshme, të fituar, të zotëruar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimit të rregullave të etikës, si dhe i përmbushjes së detyrave nga punonjësi, në përputhje me ligjin e vetingut nr.12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Ky lloj vlerësimi përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit me gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo përtej 7 vjetëve.

### Vlerësimi i aftësive profesionale (neni 43)

Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është

Figura nr.3

### OBJEKT I VLERËSIMIT:



### 3.4 ZBATIMI I PROCESIT TË VETINGUT NË POLICI

#### 3.4.1 Faza paraprake: vetëdeklarimi i subjekteve

Rezultati i fazës së vetëdeklarimit është dorëzimi i formularëve dhe dokumentacionit të vetëdeklarimit të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, SHÇBA-së dhe Gardës së Republikës. Me hyrjen në fuqi të ligjit për vetingun në polici, pritej që rreth 12,000 punonjës të këtyre strukturave duhet të dorëzonin deklaratat individuale. Me

qëllim asistimin, këshillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të dorëzimit të dokumenteve që zgjati deri në 7.5.2018, në të trija institucionet u adoptua një skemë ndihmëse. Burime njerëzore shtesë u vendosën pranë personave ekzistuese, me qëllim asistencën e vazhdueshme të punonjësve gjatë fazës së deklarimit.<sup>45</sup> Autoritetet hartuan dhe publikuan materiale udhëzuese për të lehtësuar procesin. Megjithatë, të intervistuarit nga përfaqësuesit e subjekteve të vlerësimit kanë deklaruar se për shkak të afatit të shkurtër kohor, si dhe numrit të madh të punonjësve të policisë subjekt vlerësimi, ata nuk arritën të informohen,

45 Procesverbali i Nënkomisionit Parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 1 tetor). Kuvendi i Shqipërisë.



udhëzohen, apo trajnohen aq sa duhet. Mungesa e informacionit, risia e procesit, koha e shkurtër me një farë nxitimi dhe masiviteti i procesit bënë që ai të përjetohej me shumë stres nga punonjësit e policisë.

Formulari i deklaratës së pasurisë është perceptuar nga të intervistuarit si më i vështiri për t'u plotësuar, pasi kërkonte saktësi në llogaritje dhe mbështetje në dokumentacion. Ndërkohë, dokumentacioni nga institucionet herë nuk gjendej dhe herë jepej me vonësë. Sipas të dhënave të sindikatës së punonjësve të PSH-së, rreth 20% e punonjësve kanë raportuar vështirësi gjatë plotësimit të këtij formulari. Informaliteti i aktivitetit ekonomik apo qiradhënies si dhe problemet me pronësinë e pasurive të paluajtshme ndikuan aftësinë e subjekteve për ta plotësuar dokumentacionin.<sup>46</sup>

### ● **Subjektet që kanë dorëzuar deklaratat individuale dhe dorëheqjet**

Burimet zyrtare raportojnë se rreth 98% e subjekteve të secilës prej tre strukturave (punonjës të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së), i dorëzuan deklaratat individuale.<sup>47</sup> Sipas të dhënave të përcjella nga SHÇBA-ja,<sup>48</sup> numri i subjekteve që kanë dorëzuar formularin e vetëvlerësimit profesional është 10,908 nga një total prej 10,994 punonjësish, për të treja strukturat së bashku, pasqyruar në tabelën nr. 3. Edhe pse ligji parashikonte afatin 1 mujor për dorëzimin e deklaratave individuale, edhe mediat raportojnë se kjo ka qenë një kohë e pamjaftueshme për të dorëzuar informacionin e kërkuar brenda afatit, ndaj ka shkaktuar trysni dhe stres te punonjësit.<sup>49</sup> Skema e atëhershme e vlerësimit me tri faza mund të parashikonte një afat tjetër të mëvonshëm për dorëzimin e vetëdeklarimit të subjekteve të dy fazave të tjera.

**Tabelë nr. 3: Të dhënat për subjektet e vlerësimit të ndara sipas strukturave**

INSTITUCIONI	NUMRI I PUNONJËSVE	FORMULARË TË DORËZUAR	TË DORËHEQUR
<b>POLICIA E SHTETIT</b>	9,539	9,496	229
<b>SHÇBA</b>	113	103	2
<b>GARDA E REPUBLIKËS SHQIPËRISË</b>	1,342	1,309	32
<b>TOTALI</b>	10,994	10,908	263

Burimi: SHÇBA, 2019

■ ■

46 Në bazë të intervistave të thelluara të zhvilluara me përfaqësuesit e sindikatës dhe subjektet e vlerësimit. (2020).

47 Procesverbali i Nënkomisionit Parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2018, 1 tetor). Kuvendi i Shqipërisë.

48 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. (2019). Kthim përgjigje nr. 102/1 prot., datë 26.6.2019. [Komunikim zyrtar me IDM-në].

49 Delia, E. (2019, 1 mars). Ndryshon ligji, vetingut në Polici do i nënshtrohen vetëm 300 drejtuesit. Të tjerët. Panorama online. <http://www.panorama.com.al/ndryshon-ligji-vetingut-ne-polici-do-i-nenshtrohen-vetem-300-drejtuesit-te-tjeret/>

Të dhënat e grumbulluara nuk ofrojnë një tablo më të qartë në lidhje me shpërndarjen e punonjësve sipas rajoneve, gjinisë, përvojës në punë dhe gradave për subjektet që kanë dorëzuar në kohë formularët përkatës. Nga të dhënat e ofruara nga KJV-ja, deri tani nuk ka patur asnjë kërkesë nga ish-punonjësit e këtyre institucioneve për t'iu nënshtruar vlerësimit kalimtar me vullnet të lirë<sup>50</sup>, siç parashihet në nenin 6, pika 5 e ligjit 12/2018 për vetingun në polici.

### ● **Dorëheqjet gjatë fazës së vetëdeklarimit**

Ligji u jep të drejtën punonjësve të japin dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e ligjit (pika 1, neni 57, ligji 12/2018). Konstatohet se rreth 2.4% e subjekteve kanë dhënë dorëheqjen gjatë fazës së vetëdeklarimit, përqindje e barasvlershme me rreth 263 punonjës të policisë nga numri total prej 10,994.<sup>51</sup>

### **3.4.2 Faza e parë e vlerësimit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit**

Pas përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik nga Bordi Përzgjedhës në shkurt të vitit 2019<sup>52</sup>, konstituimit të organeve në shkurt dhe realizimit të trajnimit të stafit, më 30.5.2019 KJV-ja filloi punën de facto duke nisur procesin e vetingut për subjektet e vlerësimit të nivelit të lartë drejtues. Gjatë kësaj faze vlerësimi u ndoqën një sërë procedurash: a) procedura e shortimit të subjekteve të vlerësimit; b) vlerësimi/hetimi administrativ i subjekteve të vlerësimit; c) zhvillimi i seancave dëgjimore me subjektet e vlerësimit.

Megjithatë, ecuria e deritanishme ka pasur një ritëm tepër të ngadaltë, duke bërë që të tejkalohen afatet e parashikuara në ligj për zbatimin e këtyre procedurave.

### ● **a. Procesi i shortimit i subjekteve të vlerësimit: fazat dhe të dhënat e disagreguara mbi subjektet**

Në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 12/2018 për vetingun, i ndryshuar, pas miratimit të listës së subjekteve<sup>53</sup>, KJV-ja ka realizuar dy njoftime për publikimin e listës me emrat e subjekteve që i janë nënshtruar shortit, sipas rregullores përkatëse të miratuar nga KJV-ja. Me qëllim rritjen e transparencës, gjatë hedhjes së shortit kanë qenë të ftuar edhe anëtarë nga Nënkomisioni Parlamentar për mbikëqyrjen e vetingut në polici, si dhe partnerë ndërkombëtarë, përfaqësues nga PAMECA dhe ICITAP-i.<sup>54</sup> Përfaqësues të medias kanë deklaruar gjatë intervistimit se procesi i shortimit ka qenë transparent, megjithatë përfaqësues nga sindikata nuk janë lajmëruar dhe përfshirë në këtë proces, edhe pse kanë shprehur interes.

### **Faza 1: subjektet e shortuara për vetingun**

Në datën 3.6.2019, KJV-ja hodhi shortin për 45 subjektet e para që iu nënshtruan procesit të vetingut.<sup>55</sup> Të dhënat e disagreguara sipas institucionit, gradës, gjinisë dhe pozicionit të 45 subjekteve të vlerësimit rezultojnë si më poshtë:

- 31 janë punonjës të Policisë së Shtetit, 2 janë punonjës të Gardës së Republikës, 12 janë punonjës të SHÇBA-së;

■ ■

50 Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. (2020). Kthim përgjigje shkresës, nr. 7.1.2020 prot, datë 30.1.2020, me lëndë "Kërkesë për informacion mbi procesin e vetingut në Polici", hyrë në KJV me nr. 35 prot., datë 12.2.2020. [Komunikim zyrtar me IDM-në].

51 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Kthim përgjigje nr. 102/1 prot., datë 26.6.2019.

52 Përzgjidhen anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik për Vettingun në Polici, Gardë e SHÇBA. (2019, 11 shkurt). Ministria e Brendshme. <https://mb.gov.al/2019/02/11/perzgjidhen-anetaret-e-komisionit-te-jashtem-te-vleresimit-dhe-sekretariatit-teknik-per-vettingun-ne-polici-garde-e-shcba/>

53 Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. (2019). Vendim nr. 17/2 prot. data 20.5.2019.

54 Procesverbali i Nënkomisionit Parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2019, 13 shtator). Kuvendi i Shqipërisë. <http://parlament.al/Files/Procesverbale/20191018110740Nenkomision%20%20i%20Vetingut%20dt%2013.09.2019.pdf>

55 Lista e subjekteve për shortimin e pare. (2019, 8 korrik). Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. <http://kjav.al/lista-e-45-dyzet-e-pese-subjekteve-per-shortimin-e-pare/>


- 44 janë meshkuj dhe vetëm 1 femër;
- 40 mbajnë pozicion në nivel drejtori, 3 zëvendësdrejtorë; 1 komandant dhe 1 zv/komandant.

### Faza 2: subjektet e shortuara për vetingun


Më datë 31.10.2019, KJV-ja shpalli njoftimin për hedhjen e shortit të dytë për 47 subjektet<sup>56</sup> e tjera të vetingut që do t'i nënshtrohen vlerësimit, nga të cilët:

- 47 janë punonjës të Policisë së Shtetit;
- 46 janë meshkuj dhe vetëm 1 është femër;
- 5 janë me gradën Drejtues i Parë, 1 me gradë Drejtues i Lartë; 27 me grada Drejtues, 14 Kryekomisar;
- 24 mbajnë pozicionin drejtor, 23 zëvendësdrejtorë.

**Figura 4: Shpërndarja e subjekteve të vlerësimit sipas institucioneve**



**Figura 5: Shpërndarja e subjekteve të vlerësimit sipas institucioneve**



Në të dyja raundet e shortimit të subjekteve të vetingut janë përzgjedhur gjithsej 92 subjekte, nga të cilat 85% janë punonjës së Policisë së Shtetit, 13% subjekte nga SHÇBA-ja, vetëm 2% janë përfaqësues të Gardës. 70% e subjekteve mbajnë funksionin e drejtorit, 28% janë zv/drejtor dhe vetëm 2% janë komandantë/zv.komandantë.

Sipas ligjit 12/2018, të ndryshuar, faza e dytë e procesit duhet të zbatohet nga SHÇBA-ja dhe punonjësit e angazhuar në këtë proces duhet ta kenë kaluar në mënyrë të suksesshme vetingun. Të dhënat tregojnë se aktualisht janë vlerësuar vetëm 15 subjekte të vlerësimit nga 92 të shortuar dhe rreth 245 punonjës në total, nga të cilët 12 subjekte vlerësimi nga 92 i përkasin SHÇBA-së. Në subjektet e vlerësuar përfshihen edhe punonjës të SHÇBA-së. Kjo e fundit deklaron se ka krijuar aktualisht një ekip me 45 punonjës që po trajnohen për këtë qëllim. Nuk është e qartë nëse ky ekip ka në përbërje punonjës të cilët e kanë kaluar vetimin, por ngadalësia e procesit në fazën e parë do të ndikojë edhe në ritmin e fazës së dytë. Ndërkohë parapërgatitjet aktuale duket sikur dëmtojnë kriteret e vendosura për fazën e dytë.

56 Lista e subjekteve për shortimin e dytë. (2019, 31 tetor). Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. <http://kju.al/lista-e-subjekteve-per-shortimin-e-dyte/>


● **b. Vlerësimi administrativ i subjekteve të vlerësimit**

Me hedhjen e shortit të parë, nisi puna për shqyrtimin administrativ të 45 dosjeve të para të drejtuesve të lartë të PSH-së, SHÇBA-së dhe Gardës së RSH-së. Pas përfundimit të hetimit, shqyrtimit të deklaratave, kërkimit të informacioneve dhe verifikimeve përkatëse, KJV-ja vijoi punën për zhvillimin e seancave të hapura dëgjimore për secilin subjekt.

● **c. Zhvillimi i seancave dëgjimore me subjektet e vlerësimit të vetingut**

Në datën 5.11.2019 KJV-ja zhvilloi seancën e parë dëgjimore, rreth 16 javë pas publikimit të listës së parë të subjekteve të shortuara. Gjatë periudhës nëntor 2019–mars 2020, KJV-ja ka vlerësuar 16.3% të subjekteve të shortuara dhe ka kryer 15 seanca dëgjimore për subjektet e vlerësimit kalimtar. Ritmet me të cilat janë zhvilluar seancat dëgjimore mund të konsiderohen të ngadalta (mesatarisht 3-4 seanca në muaj) në raport me numrin total të subjekteve që janë shortuar deri më tani nga KJV-ja. Shpërndarja e seancave dëgjimore për këtë periudhë vijon si më poshtë:

**Figura 6: Numri i Seancave dëgjimore gjatë periudhës Nëntor 2019–Mars 2020.**



● **d. Vendimet e nxjerra nga KJV-ja**

Gjatë kësaj periudhe, trupat e vlerësimit të KJV-së kanë marrë 15 vendime për subjektet e vlerësimit kalimtar,<sup>57</sup> duke vendosur:


a) konfirmimin në detyrë për 12 subjekte;

b) përjashtimin nga detyra për 3 subjekte, nga të cilët:

- 1 subjekt u përjashtua nga detyra;
- 2 subjekte të tjera dhanë dorëheqjen nga procesi i vlerësimit kalimtar.


■ ■  
<sup>57</sup> Bazuar në nenin 59, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, në përfundim të procesit të vlerësimit të punonjësit, trupa e vlerësimit vendos: 1) konfirmimin në detyrë; 2) detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Akademia e Sigurisë; 3) detyrimin e titullarit të institucionit për emërimin në detyrë të ish-punonjësve; 4) përjashtimin nga detyra.

Figura 7: Rastet e vlerësuara nga KJV-ja gjatë periudhës nëntor 2019–mars 2020



Burimi: Të dhëna nga KJV-ja dhe llogaritje të autorëve

Figura 8: Shpërndarja e vlerësimeve sipas vendimit



Ndër vendimet e marra, 80% rezultojnë pozitive dhe tregojnë një konfirmim të punonjësve në detyrë. Kjo shkallë e konfirmimit është e lartë, sidomos krahasuar me rezultatin e këtij procesi në sistemin e drejtësisë.

**e. Shpallja dhe publikimi i vendimeve**

Sipas nenit 56, pikës 8 të ligjit nr. 12/2018 të vetingut, i ndryshuar, vendimi i trupës vlerësuese të KJV-së shpallet në fund të seancës dëgjimore dhe i njoftohet edhe me shkrim punonjësit, brenda 15 ditëve pas përfundimit të seancës. Nga monitorimi konstatohet se:

- Koha mesatare e shpalljes së vendimeve të marra nga trupat vlerësuese të KJV-së është rreth 4 ditë pas përfundimit të seancës.
- Koha mesatare e shpalljes së vendimeve nga trupat vlerësuese të KJV-së për subjektet që kanë paraqitur kërkesë për pushim të procesit të vlerësimit kalimtar, varion nga 2 ditë për njërin subjekt deri rreth 4 muaj e gjysmë për subjektin tjetër, pas marrjes së kërkesës.
- Të gjitha vendimet e trupave vlerësuese të KJV-së për subjektet e vlerësimit janë publikuar në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

● **f. Vendimet për përjashtimin nga detyra të subjekteve të vlerësimit**

Shefi i Sektorit për Trajtimin e Ankesave në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA-së ishte zyrtari i parë që u përjashtua nga detyra në radhët e policisë. Vendimi argumentohet si vijon: “subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe ka mangësi të aftësive profesionale për zbatimin e përkrahjeve të punës për atë funksion”.<sup>58</sup>

● **g. Ankimi i vendimeve të KJV-së**

Sipas përcaktimeve të ligjit për vetingun në polici vendimet e KJV-së mund të ankimohen drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente. Ligji në fuqi nuk parashikon një strukturë ankimore të vendimeve të KJV. Deri më tani, dy vendime të KJV-së janë ankimuar në Gjykatën Administrative Tiranë, nga subjektet e vlerësuar. Në të dyja këto procese gjyqësore, KJV është përfaqësuar nga një anëtar i Sekretariatit Teknik me përvojë në këtë fushë. Ligji në fuqi nuk parashikon modalitete për përfaqësimin ligjor të KJV-së në procese gjyqësore. Për të dyja rastet gjyqësore, Gjykata Administrative Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e KJV-së. Njëri nga vendimet e gjykatës është ankimuar nga pala paditëse në Gjykatën e Apelit.<sup>59</sup>

● **h. Subjektet e dorëhequra gjatë fazës së hetimit administrativ**

Ligji nr.12/2008, neni 57/1, u jep të drejtë subjekteve të vetingut të tërhiqen nga detyra jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit. Vendimet e KJV-së në lidhje me rastet e dorëheqjeve gjatë fazës së hetimit administrativ merren në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin e unifikuar të

KJV-së,<sup>60</sup> edhe pse ligji i vetingut nuk parashikon ndonjë dispozitë konkrete ligjore, e cila autorizon nxjerrjen e një akti të tillë nga ana e KJV-së. Për rrjedhojë, vendimi i unifikuar nuk është në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 12/2008.

Në këtë kuadër, trupat e vlerësimit të KJV-së kanë vendosur ndërprerjen e procesit të vlerësimit për 2 subjekte gjatë fazës së hetimit administrativ, pasi kanë marrë në dijeni kërkesat e tyre për pushimin e procesit të vetimit për shkak të dorëheqjes. Njëri subjekt ka ushtruar funksionin e drejtorit të Institutit të Policisë Shkencore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), kurse subjekti tjetër ka ushtruar funksionin e drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në DPPSH. Pasi verifikoi aktet e lirimt nga institucioni përgjegjës përkatës, trupa e vlerësimit i deklaroi të përfunduara çështjet e hetimit administrativ ndaj subjekteve të vlerësimit. Në vendimin e saj konstatohet se ndërprerja e procesit të vlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të vlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative pa një vendim përfundimtar, pasi objekti për të cilin kishte nisur procedura, apo qëllimi i saj është bërë ligjërish i pamundur.<sup>61</sup> Një nga subjektet e dorëhequra gjatë kësaj faze është në marrëdhënie pune në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

● **i. E drejta për t'u mbrojtur e subjekteve të vlerësimit**

Në kuadër të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe në mbështetje të nenit 56, pika 3, të ligjit 12/2018, të ndryshuar, punonjësit kanë të drejtë të mbrohen vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi/përfaqësuesi të zgjedhur. Nga monitorimi i seancave dëgjimore, rezulton

■ ■

58 Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. (2019). Vendim nr. 117, datë 20.11.2019. <http://kju.al/wp-content/uploads/2019/11/VENDIM-OLTION-SHEHU.pdf>

59 Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. Kthim përgjigje shkresës, nr. 7.1.2020 prot, datë 30.1.2020, me lëndë "Kërkesë për informacion mbi procesin e vetingut në Polici", hyrë në KJV me nr. 35 prot, datë 12.2.2020.

60 Vendim nr. 116, datë 6.11.2019 "Për unifikimin e trajtimit të rasteve të dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit kalimtar sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar, gjatë fazës së hetimit administrativ nga Trupat Vlerësuese të KJV". Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

61 Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. (2019). Vendim nr. 3, datë 16.2.2019.

se vetëm dy subjekte vlerësimi janë mbrojtur nga përfaqësuesi ligjor i zgjedhur prej tyre.

### 3.5 SFIDAT GJATË PUNËS SË KJV-SË

Procesi i rivlerësimit kalimtar të punonjësve të policisë ka ecur me ritme të ngadalta, duke filluar me rreth 9 muaj vonesë nga afati i parashikuar fillimisht. Aktualisht janë shortlistuar për vlerësim vetëm 23% e subjekteve të fazës së parë, ndërkohë që për periudhën nëntor 2019–mars 2020 janë vlerësuar vetëm 16% e subjekteve të shortlistuara. Vonesat lidhen kryesisht me konstituimin e organeve të vlerësimit, nxjerrjen e akteve nënligjore për mbarëvajtjen e gjithë procesit, ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KJV-së e sekretariatit teknik, si dhe infrastrukturën financiare dhe logjistike të nevojshme në funksion të procesit. Nga intervistat e thelluara me përfaqësues të autoriteteve apo grupe të interesit, është theksuar se vonesat janë edhe si pasojë e burimeve njerëzore të pamjaftueshme të KJV-së, apo dhe nga vonesat në marrjen e informacionit të duhur për vlerësimin e subjekteve në kohë (në 15 ditë nga dërgesa e kërkesës për informacion). Më poshtë po paraqesim në mënyrë të përmbledhur një përshkrim të vijueshmërisë së procesit dhe sfidave.

#### **Trajnimi i anëtarëve të KJV-së**

Anëtarët e KJV-së si dhe anëtarët e sekretariatit teknik përkatës janë trajnuar nga disa institucione publike si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, DSIK-u, Komisioni i Pavaruar i Kualifikimit, SHISH-i, SHÇBA-ja dhe Shkolla e Magjistraturës. Çështjet e trajnimit kanë prekur edhe tematika të punës së këtyre institucioneve që përfshihen në objektin e vlerësimit të subjekteve. Trajnimet janë vlerësuar si shumë të rëndësishme për njohjen e procesit dhe ndërtimin e praktikave të komunikimit ndër-institucional. Numri i trajnimeve, temat e trajnimeve dhe pjesëmarrësit nuk janë raportuar nga KJV-ja.

■ ■

#### **Buxheti i vetingut**

Mbulimi financiar i procesit të vetingut rezulton vetëm në fondin e pagave të anëtarëve të KJV-së dhe atyre të sekretariatit teknik. Në përputhje me nenet 29 dhe 66, pika 1 të ligjit të vetingut, trajtimi financiar për anëtarët e Bordit Përzgjedhës, anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, si dhe anëtarët e sekretariateve teknike, përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. VKM-ja për trajtimin financiar të anëtarëve është miratuar përtej afatit të parashikuar fillimisht në ligj, duke shkaktuar vonesa në fillimin e punës së KJV-së. Burimet financiare që mbulojnë aspekte logjistike të zhvillimit normal të aktivitetit të KJV-së nuk janë të identifikueshme në buxhetin e Ministrisë së Brendshme. Kjo ka pamundësuar vlerësimin e burimeve financiare në mbështetje të këtij procesi. Aktualisht buxheti i KJV-së llogaritet të jetë 42 milion lekë. Raporti mes buxhetit dhe shpenzimeve faktike për vitin 2019 është 95% (shih tabelën 5).

#### **Aksesi në infrastrukturë dhe mbështetja logjistike**

Referuar nenit 30 të ligjit për vetingun, Ministria e Brendshme siguron mjediset e punës së organeve të vlerësimit dhe i siguron KJV-së logjistikën e nevojshme për të ushtruar përgjegjësitë që i ngarkon ky ligj. Pas identifikimit të godinës në ambientet e Gardës së RSH-së, projektimit të ndërhyrjes, prokurimit dhe zbatimit të ristrukturimit dhe rehabilitimit të saj, në maj 2020, KJV-ja filloi punën normalisht. Asetet logjistike për mbarëvajtjen e punës së anëtarëve të KJV-së dhe anëtarëve të sekretariatit teknik (pajisje zyrash, kompjutera etj.) janë siguruar nga MB dhe janë vënë në dispozicion të anëtarëve. Sipas informacionit të përcjellë nga KJV-ja, akoma nuk janë marrë masat e duhura në lidhje me ruajtjen e sigurisë fizike të anëtarëve të organeve të vlerësimit.<sup>62</sup>

62 Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. Kthim përgjigje shkresës, nr. 7.1.2020 prot, datë 30.1.2020, me lëndë "Kërkesë për informacion mbi procesin e vetingut në Polici", hyrë në KJV me nr. 35 prot, datë 12.2.2020.

### **Burimet njerëzore mbështetëse për KJV-në**

KJV-ja raporton se ka mungesë burimesh njerëzore mbështetëse për mbarrëvajtjen e punëve të saj, të tilla si: trajtimi i ankesave, kërkesave për informacion drejtuar KJV-së, kryerja e interpretimeve ligjore të veçanta për nevoja të trupave vlerësuese nga staf i dedikuar me formim në fushën e drejtësisë; vlerësimi i problematikave të veçanta në procesin e vetimit nga staf i dedikuar me njohuri të specializuara në fushën e ekonomisë, në asistencë të anëtarëve të trupave vlerësuese; publikimi i materialeve apo njoftimeve nga staf në fushën e teknologjisë së informacionit për të asistuar KJV-në; si edhe kryerja e punëve të përditshme administrative për KJV-në nga ndihmësi administrativ. KJV-ja asistohet vetëm nga një zyrë protokollit me një punonjës, i cili është pjesë e organikës së Ministrisë së Brendshme (shih tabelën 5). Mungesa e burimeve njerëzore mbështetëse për kryerjen e misionit të KJV-së ka shkaktuar mbingarkesë në punën operacionale të

këtij komisioni dhe sekretariatit teknik.<sup>63</sup> Plotësimi i strukturës së KJV-së me persona që kryejnë detyrat e menaxhimit logjistik, financiar, apo aktivitete të tjera mbështetëse, si dhe identifikimi i qartë i fondeve buxhetore në mbështetje të aspekteve operacionale të zyrës së KJV-së, janë detaje themelore për të siguruar ecurinë dhe pandikueshmërinë e këtij procesi.

### **Ndryshime anëtarëve dhe sekretariatit teknik**

KJV-ja raporton se ka patur ndryshime të anëtarëve të KJV-së dhe sekretarit teknik përgjatë vijueshmërisë së punës. Në pjesën më të madhe të rasteve, këto ndryshime kanë ndodhur si pasojë e dorëheqjeve të anëtarëve dhe vetëm në një rast për shkak të mospërmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e komisionerit.<sup>64</sup> Zëvendësimet e anëtarëve të organeve vlerësuese kanë shkaktuar vonesa në mbarrëvajtjen e procesit të vetingut.<sup>65</sup>

**Tabela 5: Tregues të vlerësimit të kapaciteteve institucionale të KJV-së**

<b>TREGUES TË VLERËSIMIT</b>	<b>TË DHËNA ADMINISTRATIVE</b>
Numri i strukturave të reja të krijuara	Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit: strukturë ad-hoc
Numri i strukturave që pritet të krijohen deri në fund të procesit	Transferim i funksioneve në SHÇBA
Numri aktual i komisionerëve	15
Nga të cilët femra:	10
Sekretariati teknik	15
Nga të cilët femra	9
Numri aktual i stafit teknik mbështetës	1
Buxheti i institucioneve të vetingut në polici	42,000,000 ALL
Raporti buxhet/shpenzimet faktike për 2019-n	95%

■ ■

63 Për më shumë detaje shihni: Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. (2019, 13 gusht). Njoftim. <http://kqv.al/njoftim-2/>; Procesverbali i Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2019, 13 shtator). Kuvendi i Shqipërisë.

64 Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. Kthim përgjigje shkresës, nr. 7.1.2020 prot, datë 30.1.2020, me lëndë "Kërkesë për informacion mbi procesin e vetingut në Polici", hyrë në KJV me nr. 35 prot, datë 12.2.2020.

65 Bajraktaraj, B. (2019, 29 shtator). Tre komisionerë për vettingun e policisë dorëhiqen nga puna. Ora News. <https://www.oranews.tv/article/tre-komisionere-vettingun-e-policise-dorehiqen-nga-puna>





TREGUES TË VLERËSIMIT	TË DHËNA ADMINISTRATIVE
Numri i trajnimeve për stafin e vetingut	NA
Numri i pjesëmarrësve në trajnime	NA
Web Page	1
Databaza, standardizimi, informacioni dhe përpunimi	NA
Nr. i rasteve të vlerësimit për çdo komisioner të KJV-së	20
Volumi i shkresave administrative për çdo rast vlerësimi	50
Numri i rasteve në proces vlerësimi për anëtar të KJV-së	6
Numri i procedurave të prokurimit	0
Numri i ekspertëve të angazhuar në ngritjen e institucionit	0

*Burimi: Të dhëna administrative nga KJV-ja dhe MB-ja*

### **Pezullimi i punës së KJV-së për shkak të situatës së COVID-19**

Për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19 në vend dhe në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar prej tij, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit njoftoi më datë 18.3.2020 kufizimin e veprimtarisë së tij institucionale. Nga ajo kohë, KJV-ja ka kryer vetëm ato funksione organizative që mund të përmbushen në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit elektronik dhe telefonik zyrtar. KJV-ja ka njoftuar shtyrjen e afateve për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore për subjektet e vlerësimit deri në një njoftim të dytë zyrtar gjatë kësaj periudhe.<sup>66</sup> Në 20 maj 2020 është shpallur njoftimi i seancave dëgjimore me subjektet e vlerësimit.

### **3.6. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET DHE AKTORËT E INTERESUAR**

#### ***Bashkëpunimi me institucionet informacion-ofruese në kuadër të procesit të vetingut në polici***

KJV-ja është duke administruar një volum të madh dokumentacioni në kuadër të hetimit administrativ të subjekteve të vlerësimit, i cili përfshin verifikimin dhe kërkimin e të dhënave të pakufizuara dhe ndërmarrjen e një sërë veprimesh procedurale për vërtetimin e provave lidhur me kontrollin e figurës, pasurisë dhe profesionalizmit. Me qëllim verifikimin e dokumentacionit, KJV-ja është duke bashkëpunuar me shumë institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, si dhe me vet subjektet e vlerësimit. Për shkak të vet natyrës së hetimit administrativ, KJV-ja është në proces pritjeje dhe verifikimi të një sërë përgjigjesh nga institucionet të cilave iu është drejtuar për kërkim të dhënash lidhur me subjektet, por dhe personat e lidhur me ta.<sup>67</sup> Sipas raportimit të kryetares së KJV-së<sup>68</sup>, vonesat në përcjelljen e informacionit të kërkuar kanë shkaktuar ritme të ulëta pune



<sup>66</sup> Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. (2020, 18 mars). Njoftim. <http://kju.al/njoftim-3/>

<sup>67</sup> Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. (2019, 13 gusht). Njoftim. <http://kju.al/njoftim-2/>

<sup>68</sup> Procesverbali i Nënkomisionit Parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të vetingut. (2019, 13 shtator). Kuvendi i Shqipërisë, f. 8-12.

të KJV-së. Një nga arsyt kryesore lidhet me përplasjen e afateve ligjore të kthim-përgjigjes së parashikuar nga ligji 12/2018 dhe afateve të shyrtimit të kërkesës e dhënies së informacionit nga institucionet e tjera, të cilat rregullohen e operojnë sipas ligjeve të veta organike. Gjithashtu, janë shkaktuar vonesa edhe nga paqartësia e informacionit të ofruar nga institucionet, të cilave KJV-ja i është përgjigjur me kërkesa për sqarime të mëtejshme; mungesës së bashkëpunimit me disa prej tyre,<sup>69</sup> si dhe lëvizjeve të shpeshta në detyrë të drejtuesve të policisë dhe të Gardës së Republikës.

### ***Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare***

Partnerët ndërkombëtarë kanë një rol monitorues dhe këshillues përgjatë gjithë procesit të vetingut, me synim ruajtjen e cilësisë, zbatimit të njëjtë të standardeve dhe mbështetjen e transparencës së vetë këtij procesi.<sup>70</sup> Aktualisht, nuk rezulton i publikuar ndonjë raport monitorimi mbi mbarëvajtjen e këtij procesi nga këto institucione. Sipas monitorimit të realizuar nga IDM-ja, nuk rezulton të ketë patur interes nga këto institucione për të asistuar teknikisht dhe financiarisht aspekte të veçanta të këtij procesi.

### ***Bashkëpunimi dhe përfshirja e publikut në procesin e vetingut***

Në nenin 55/4 të ligjit të vetingut në polici parashikohet që KJV-ja të publikojë një model përfundim informacioni, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së tij nga publiku. Çdo person që vihet në dijeni të fakteve, ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me procesin e vlerësimit për punonjës të subjektit të hetimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt organet e vlerësimit, sipas nenit 55/1 të ligjit 12/2018, të ndryshuar.

■ ■

69 Dy institucionet kushtetuese si Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, nuk kanë bashkëpunuar për dorëzimin e dokumenteve në kohë, duke u bërë pengesë për mosnisen në kohë të procesit të Vettingut në radhët e policisë. Shihni Vettingu në polici, Kapaj: Pse ngeci procesi. (2019, 13 shtator). ABC News. <https://abcnews.al/vettingu-ne-polici-kapaj-pse-ngeci-procesi/>

70 Nis vettingu në polici, ja kush rrezikon të mos kalojë procesin. (2018, 9 prill). Argjiro. <https://argjirolajm.net/zyrtarizohen-ndryshimet-ne-policine-e-shtetit-emrat/>

71 Për më shumë detaje vizitoni: <http://kju.al/denonco/>

72 Komisioni për Vlerësimin e Jashtëm. Kthim përgjigje shkresës, nr. 7.1.2020 prot, datë 30.1.2020, me lëndë "Kërkesë për informacion mbi procesin e vetingut në Polici", hyrë në KJV me nr. 35 prot, datë 12.2.2020.

Denoncimet nga publiku arrijnë në KJV nëpërmjet rubrikës "Denonco" të vendosur në faqen zyrtare të KJV-së,<sup>71</sup> si dhe nëpërmjet postës zyrtare. Deri më tani evidentohen 8 denoncime nga publiku në lidhje me subjektet e vetingut.<sup>72</sup> Denoncimet i përcillen menjëherë relatorit përkatës, përgjegjës për vlerësimin e subjektit. Trupa vlerësuese, me marrjen e një denoncimi, vijon me procesin e verifikimit të tij. Denoncimet e ardhura bëhen publike në seancat dëgjimore nga ana e relatorit duke ruajtur anonimat e denoncuesve.

### ***Bashkëpunimi me institucionet e pavarura, media dhe publiku***

Sipas monitorimit të realizuar nga IDM-ja, institucionet e pavarura, media dhe publiku nuk rezultojnë të kenë pasur interes për të kryer analiza të thelluara përmbajtësore, apo raporte monitoruese për zbatimin e procesit të vetingut. Vërehet një qasje e ndryshme e tyre krahasuar me vëmendjen për procesin e vetingut në gjyqësor. Seancat dëgjimore për subjektet e vetingut kanë qenë të hapura për publikun e gjerë dhe median. Ato janë monitoruar nga gazetarë, aktorë të shoqërisë civile, institucione ndërkombëtare dhe publiku i interesuar.

### 3.7 VLERËSIMI I TRANSPARENCËS SË PROCESEVE TË VETINGUT

#### **Publikimi i informacioneve mbi ecurinë e procesit të vetingut**

Në kuadër të transparencës dhe garantimit të drejtës së informimit, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit bën publike në mënyrë periodike veprimtarinë e tij, përmes publikimeve të informacioneve mbi ecurinë e procesit, apo për aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tij.

Faqja zyrtare e KJV-së përfshin rubrikën e Programit të Transparencës, por ky program nuk është i aksesueshëm.<sup>73</sup>

#### ***Njoftimet për zhvillimin e seancave dëgjimore për subjektet e vlerësimit***

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit njofton rregullisht datat e parashikuara për zhvillimin e seancave dëgjimore për subjektet e vlerësimit. Nga vlerësimi i faqes zyrtare të KJV-së, konstatohet se njoftimi paraprak për zhvillimin e seancave dëgjimore varion nga një ditë deri në katër ditë përpara mbajtjes së tyre. Ky afat njoftimi vlerësohet i shkurtër në kohë për të mundësuar pjesëmarrjen e publikut apo aktorëve të interesuar në këto seanca. Përgjithësisht, vihet re një dinamikë e shpejtë në lidhje me publikimin<sup>74</sup> e vendimeve të shpallura për subjektet e vlerësimit kalimtar.



73 Shihni në <http://kju.al/program-transparence/>

74 Për më shumë detaje, vizitoni <http://kju.al/category/njoftime/>

## IV. PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Disa nga vendet e bllokut lindor i zbatuan qysh në vitet '90 masat e pastrimit të aparatit shtetëror sipas praktikave të drejtësisë tranzitore. Republika e Shqipërisë (RSH) që nga të parat shtete pasocialiste që ndërmori hapa në këtë drejtim duke themeluar organet e para të vlerësimit të figurës që në vitin 1993. Policia e Shtetit (PSH) ka qenë në fokusin e ligjit të kontrollit të figurës që nga viti 1995 dhe, që prej asaj kohe, disa ligje të tjera kanë themeluar organe me attribute dhe funksione të përgjithshme vetingu. Përdorimi dhe instrumentalizimi i këtyre organeve dhe ligjeve ka bërë që organet të çlegjitimohen dhe proceset të ndërpriten.

Për shkak të mosfunksionimit të këtyre mekanizmave kontrolluese dhe rritjes së vëmendjes publike që Policia e Shtetit mori pas raportimeve, akuzave dhe dëshmive për përfshirjen e saj në trafikimin e bimeve narkotike, në vitin 2017 Ministria e Brendshme u detyrua të ndërmerre masa për tejkalimin e kësaj gjendjeje shqetësuese. Mbështetur në analizën e plotë të situatës, u propozua zbatimi i një instrumenti antikorrupsion, siç është ai i vetingut në polici. *Qëllimi parësor i vetingut në Policinë e Shtetit do të ishte garantimi dhe promovimi i integritetit si edhe rritja e profesionalizmit në radhët e punonjësve të agjencive shqiptare përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Procesi i vlerësimit të punonjësve të policisë do të zbatohet nga organe të pavarura dhe do të bazohet në kontrollin e figurës, pasurive dhe profesionalizmit të punonjësve të policisë.*

Ky objektivi politik u materializua me miratimin e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së, në Ministrinë e Brendshme", i cili hyri në fuqi më 4 prill të 2018-ës. Sipas përcaktimeve të këtij ligji, në respekt të precedentit të vendosur nga legjislacioni për reformën në drejtësi, vlerësimi kalimtar i punonjësve të policisë do të kryhet për tre komponentë vlerësimi: kontrolli i figurës, kontrolli dhe verifikimi i pasurisë dhe i nivelit profesional sipas gradës, funksionit, llojit të detyrës, si dhe përgjegjësisë që ka çdo punonjës policie. Procesi i vlerësimit do të kryhet në dy faza, sipas tipologjisë së gradave dhe funksioneve në këto

tre institucione. Sistemi i gradave lejon ndarjen e subjekteve të vlerësimit në tre kategori kryesore: grada të larta, të mesme dhe të ulëta.

Zbatimi i ligjit filloi me fazën e vetëdeklarimit, dorëzimit të formularëve dhe dokumentacionit nga të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, SHÇBA-së dhe Gardës së Republikës. Afërsisht 10,908 punonjës i plotësuan dhe dorëzuan formularët në këtë fazë, ndërkohë 2.4 % e punonjësve u tërhoqën nga ky proces (263 punonjës). Formulari i deklaratës së pasurisë është perceptuar nga të intervistuarit si më i vështiri për t'u plotësuar, pasi kërkonte saktësi në llogaritje dhe mbështetje në dokumentacion, e ky i fundit herë nuk gjendej e herë jepej me vonesë nga institucionet përgjegjëse. Sipas të dhënave të sindikatës së punonjësve të PSH-së, rreth 20% e punonjësve kanë raportuar vështirësi gjatë plotësimit të këtij formulari.

Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të policisë ka ecur me ritme të ngadalta, duke filluar me rreth 9 muaj vonesë nga afati i parashikuar fillimisht. Aktualisht janë shortlistuar për vlerësim vetëm 23% e subjekteve të fazës së parë, ndërkohë që gjatë periudhës nëntor 2019–mars 2020 janë vlerësuar vetëm 16% e subjekteve të shortlistuara. Vonesat lidhen kryesisht me konstituimin e organeve të vlerësimit, nxjerrjen e akteve nënligjore për mbarëvajtjen e gjithë procesit, ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KJV-së dhe sekretariatit teknik, si dhe infrastrukturën financiare dhe logjistike të nevojshme në funksion të procesit. Në intervistat e thëlluara me përfaqësues të autoriteteve e grupeve të interesit është theksuar se shkak i vonesave është edhe pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore të KJV-së dhe vonesa në marrjen e informacionit të duhur për vlerësimin e subjekteve brenda afatit 15 ditor nga dërgesa e kërkesës për informacion, siç përcaktohet në ligj.

Partnerët ndërkombëtarë kanë një rol monitorues dhe këshillues përgjatë të gjithë procesit të vetingut, me synim ruajtjen e cilësisë, zbatimin e njëjtë të standardeve dhe mbështetjes së transparencës së vetë këtij procesi. Pavarësisht angazhimit, nuk rezulton që këto institucione të kenë publikuar raporte monitorimi mbi

mbarëvajtjen e këtij procesi. Nënkomisioni Parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për vetingun nuk ka publikuar raporte periodike monitorimi mbi ecurinë e procesit. Gjithashtu, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, veprimtaria e të cilit është publike, nuk ka hartuar dhe publikuar ndonjë raport monitorimi apo vetëvlerësimi mbi procesin.

Modeli i zgjedhur për zbatim me dy faza dhe me përfshirjen e SHÇBA-së do të mund të përmirësojë kostot e kësaj reforme, por ka nevojë të sigurojë publikun me instrumente që garantojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e reformës. Ndryshimet e fundit ligjore, ecuria e ngadaltë e procesit dhe rezultatet të cilat nuk janë ende të prekshme nga publiku e kanë zbehur besimin në arritjen e objektivave të reformës. Për këtë qëllim, **nevojitet një rikthim serioz i vëmendjes së institucioneve drejt këtij procesi, duke siguruar mbështetje politike dhe institucionale**, kapacitete të nevojshme financiare, logjistike, burime njerëzore dhe asistencë teknike për të mundësuar efektivitetin e procesit, korrigjuar ngadalësinë dhe zvarritjet e deritanishme, si dhe për të ngjallur besimin e publikut dhe grupeve të interesit në këtë reformë. Forcimi i institucionit të KJV-së përmes sigurimit të burimeve logjistike dhe njerëzore në funksion të përshpejtimit të vlerësimit dhe arritjes së objektivave do të mundësonte progres në këtë drejtim.

KJV-ja është duke administruar një volum të madh dokumentacioni në kuadër të hetimit administrativ të subjekteve të vlerësimit, i cili përfshin verifikimin dhe kërkimin e të dhënave të pakufizuara dhe ndërmarrjen e një sërë veprimesh procedurale për verifikimin e provave lidhur me kontrollin e figurës, pasurisë dhe profesionalizmit. Mbështetja politike dhe institucionale për prioritarizimin e reformës **do të siguronte konsolidimin e praktikave të komunikimit ndër-institucional, si dhe mbledhjen e përpunimit e informacionit në kohë**. Ky proces është konsoliduar ndjeshëm pas përfundimit të 15 rasteve të para, por mungesa e efektivitetit në kohë e procesit po e dëmton seriozisht besueshmërinë e tij dhe pritshmërinë se, ndryshe nga ç'ka ndodhur në përpjekjet e mëparshme, këtë herë procesi do të përfundojë me sukses dhe do ta forcojë integritetin e Policisë së Shtetit.

Institucionet e angazhuara me hartimin e politikave, kuadrit ligjor dhe zbatimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve

të Policisë së Shtetit, Gardës së RSH-së dhe SHÇBA-së duhet **të rivendosin dhe të thellojnë bashkërendimin dhe konsultimin e ndryshimeve ligjore dhe rregullative me grupet e interesit, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun**. Procesit duhet të jetë gjithëpërfshirës për shkak të masivitetit që ka, impaktit dhe përfitimeve të publikut. Ndryshimet ligjore, të domosdoshme tashmë për shkak të efikasitetit të ulët të vetingut, duhet të konsultohen për të shmangur probleme të pritshme, apo thellimin e mosbesimit të publikut në këtë proces. Përcaktimi i një afati të ri kohor për veprimtarinë e punës së KJV-së deri në përfundimin e vlerësimit të 245 punonjësve të gradave dhe funksioneve të larta, duhet të jetë pjesë e ndryshimeve të ligjit për vetingun në polici. Gjithashtu, mungesa e qartësisë ligjore të trajtimit të rasteve të dorëhequra të subjekteve të vlerësimit kalimtar gjatë fazës së hetimit administrativ nga ana e KJV-së ka ndikuar punën e këtij organi në nxjerrjen e akteve që kapërcejnë parashikimet ligjore. Edhe ky modalitet duhet të jetë objekt i rishikimit të ligjit për vetingun në polici dhe konsultimit publik. Aktivitetet që sigurojnë angazhimin e grupeve të interesit, në veçanti të partnerëve ndërkombëtarë, dhe që synojnë mbështetjen politike të reformës mund të ndërmerren nga Nënkomisioni Parlamentar që mbikëqyr ecurinë e vetingut në polici. Ai duhet të jetë më proaktiv në trajtimin e problematikave të procesit rast pas rasti, në kohë dhe me zgjidhje efektive.

Transferimi i parashikuar i procesit nga një strukturë ad-hoc si KJV-ja, në një strukturë të qëndrueshme institucionale, siguron vazhdimësi. Ky kalim do të bëjë të mundur dhe transferimin e njohurive dhe praktikave të zhvilluara nga ekspertiza e KJV-së, drejt strukturave burokratike dhe disi të ngurta të administratës publike. **Ai duhet të realizohet me mekanizma që sigurojnë kalimin e praktikës dhe standardeve të zhvilluara, vazhdimësinë e operimit të KJV-së si mekanizëm mbikëqyrës i pavarur për sigurimin e standardeve dhe paanësisë**. Në kuadrin ligjor aktual parashikohet administrimi i mëtejshëm i procesit nga SHÇBA-ja, por nuk parashkruhet se çfarë do të ndodhë me KJV-në. Shpërbërja e mundshme e organit nënkupton vazhdimësinë e një procesi vlerësimi pa asnjë mekanizëm të jashtëm të sigurimit të pandikueshmërisë. Do të ishte e udhës që **KJV-ja të vazhdonte të funksiononte si mbikëqyrëse e procesit dhe certifikimit të tij**.

Procesi i vlerësimit kalimtar dhe periodik filloi

me plotësimin dhe dorëzimin e formularëve të vetëdeklarimit nga çdo punonjës. Ai u kritikua për masivitetin dhe presionin e kohës me të cilin u përballën punonjësit gjatë përmbushjes së detyrimit ligjor. Informaliteti në ekonomi dhe vështirësia për të marrë përgjigjeve nga institucione të tjera si bankat apo hipotekat brenda afateve, mendohet të ketë ndikuar në saktësinë e informacionit. KJV-ja e zhvillon procesin e vlerësimit në komunikim me subjektet dhe u jep kohën e mjaftueshme për t'u shprehur dhe plotësuar/shpjeguar informacionin. Kjo metodikë pune ka zbutur presionin mbi punonjësit dhe ka rritur transparencën e vlerësimit. **Meqenëse procesi i vlerësimit i 12,000 punonjësve do të shtrihet në kohë, do të ishte përfituese për palët të digjitalizojë informacioni dhe të krijohen databaza të plota e të standardizuara të të dhënave të grumbulluara.** Kjo do ta lehtësonte dhe përshpejtonte procesin, pasi digjitalizimi i informacionit ndihmon në një screening të informacionit të shpejtë, gjeneron raporte vlerësuese të shpejta dhe mundëson ndërtimin e algoritmeve për të identifikuar individët me devijim/nivel risku të lartë për vlerësimin periodik.

Në kuadër të transparencës dhe garantimit të së drejtës së informimit, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit e publikon periodikisht veprimtarinë e tij. Grupe të interesit, në veçanti përfaqësuesit e subjekteve të vlerësimit, kërkojnë rritjen e kësaj transparence. **Pavarësisht komunikimit intensiv me publikun, ka shumë aspekte të veprimtarisë së**

**KJV-së, veçanërisht ato që lidhen me pavarësinë dhe pandikueshmërinë, që nuk janë transparente dhe të kuptueshme mjaftueshëm për publikun.**

Procesi dhe KJV-ja do të përfitonin nëse publiku, nëpërmjet grupeve të interesit, do të ishte i përfshirë dhe i informuar, duke pasur mundësi të gjykojë procesin. **KJV-ja, me mbështetjen e institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë, mund ta ndërtonte bashkëpunimin me grupet e interesit në formën e strukturave të qëndrueshme, p.sh. në formën e një bordi komunikimi dhe partneriteti me grupet e interesit dhe publikun.** Besimi i publikut do të forcohej nëse ky bord do të mund të ishte monitorues i vazhdueshëm i proceseve dhe dëshmitar i paanshmërisë së KJV-së.

Përtej vëmendjes që merr vlerësimi kalimtar, mekanizmi organik mirëmbajtës i shëndetit të policisë mbetet vlerësimi periodik. Deri më tani, kuadri ligjor i vlerësimit kalimtar dhe periodik nuk ka synuar përputhshmëri me kornizën e përbashkët të *acquis communautaire*-it. Me rikthimin e tagrit kontrollues tek institucioni përkatës shtetëror, shtohen mundësitë dhe nevojat për përafrimin e tij me *acquis*-in dhe për zhvillimin e mëtejshëm të agjencive/organeve që ndërlidhen me implikimet e vetingut në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar. Me rëndësi të veçantë në këtë kuadër është zhvillimi i strukturave identifikuese dhe gjurmuese të aseteve kriminale, sipas rekomandimeve të përsëritura të Komisionit Evropian.

## SHTOJCA NR. I: INTERVISAT E THELLUARA

### Monitorimi i ecurisë, arritjeve dhe impaktit të vetingut në polici

Qëllimi i intervistave të thelluara është mbledhja e informacionit, të dhënave, problematikave të hasura dhe opinioneve mbi procesin e vetingut në përgjithësi, si dhe aspekte të veçanta të zbatimit që kanë të bëjnë me krijimin e institucioneve të vetingut, praktikën e vetëdeklarimit, si dhe procesin e vlerësimit të bazuar në rastet dhe përvojën e deritanishme të procesit. Ajo u drejtohet përfaqësuesve të institucioneve politikbërëse, anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, subjekteve të vlerësimit, si dhe partnerëve ndërkombëtarë që kanë mbikëqyrur dhe mbështetur këtë proces.

Intervista është hartuar me pyetje të strukturuar dhe me një shkallë standardizimi, në mënyrë që përgjigjet e dhëna të mund të jenë të krahasueshme dhe të analizueshme. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 dhe vështirësisë për t'i realizuar këto intervista në takime direkte, pyetjet janë hartuar të atilla që të mundësojnë intervistim nëpërmjet Skype-it, ose vetëdeklarim të përgjigjeve në formë të shkruar, ose në formën e materialeve referuese që japin shpjegim për pyetjet e ngritura. Ajo është e organizuar në katër seksione, dhe ka në total 25 pyetje. Kohëzgjatja e realizimit të saj është 50 minuta.

### SEKSIONI 1: KUADRI LIGJOR DHE ASPEKTE TË NDËRTIMIT DHE FORCIMIT TË STRUKTURAVE TË VETINGUT

1. Tani që procesi i Vetingut në polici ka hyrë në fazën e zbatimit dhe konsolidimit të tij, si e gjykoni ju kuadrin ligjor të procesit që përfshin ligjin për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë dhe aktet nënligjore. A është kuadri ligjor i plotë dhe i mjaftueshëm për t'i paraprirë problematikave në zbatim? A ka qenë ky ligj/aktet nënligjore të konsultuara dhe të njohura mjaftueshëm nga të gjithë grupet e interesit? Po nga publiku?
2. A ka parashikuar kuadri ligjor masa kalimtare që rezultatet e vetingut të mos dobësojnë

institucionet, si ndodhi në rastin e procesit të vetingut në sistemin gjyqësor? (Të merret parasysh volumi i punës edhe në fazën e dytë të vlerësimit kalimtar, që përfshin rreth 12,000 punonjës me grada të mesme dhe të ulta, të cilin do ta zbatojnë vetëm punonjësit e SHÇBA-së).

3. Si i vlerësoni ju strukturat institucionale të zbatimit të vetingut? A janë ato të forta dhe me kapacitete të mjaftueshme për të realizuar misionin e tyre? A janë ato mjaftueshëm të pavarura dhe të pandikueshme nga interesa të veçanta? Nëse po, ju lutem jepni mendimin tuaj se cilat janë ato elemente që sigurojnë kapacitete të mjaftueshme dhe pavarësinë e tyre? Nëse jo, cilat janë elementet a burimet e nevojshme për të garantuar kapacitetet operuese dhe pavarësinë e strukturave? Ju lutem konsideroni kuadrin ligjor, burimet njerëzore, integritetin e institucioneve, mbështetjen me teknologji informacioni e logjistike, burimet financiare dhe administrative.
4. Zbatimi i vetingut është duke ecur me ritme të ngadalta. A ka ndikuar kuadri ligjor në zbatimin e procesit, apo kanë qenë faktorë të tjerë që kanë ngadalësuar procesin?

### SEKSIONI II: ASPEKTE TË ZBATIMIT VETINGUT

#### Faza e vetëdeklarimit:

1. Sipas mendimit tuaj procesi i vetëdeklarimit të subjekteve të vlerësimit u zhvillua i mirëkonsultuar, i mirëinformuar dhe në afate kohore që përputhen me ecurinë e reformës në tërësi?
2. Rezultat i fazës së vetëdeklarimit është dorëzimi i formularëve dhe dokumentacionit të vetëdeklarimit të të gjithë punonjësve të policisë së shtetit, SHÇBA-së dhe Gardës së Republikës. A keni dijeni sa ka qenë volumi i vetëdeklarimeve të dorëzuara?

(Informacioni i mbledhur të konsistojë në: numrin e punonjësve me grada të larta; numrin e punonjësve të policisë me grada të mesme; numri i punonjësve të policisë të dorëhequr gjatë fazës së vetëdeklarimit; shpërndarja sipas drejtorive vendore të policisë dhe komisariateve i numrit

të formularëve të vetëdeklarimeve; shpërndarja sipas gradave/pozicionit dhe komisariateve të numrit të personave të dorëhequr gjatë fazës së vetëdeklarimeve; sa kanë qënë femra nga çdo grup, sa kanë qënë të rinj).

3. Gjatë fazës së vetëdeklarimit, në dijeninë tuaj a ka pasur: kërkesa për informacion, ankesa, apo sugjerime për dokumentacionin shoqëruës dhe mënyrën e deklarimit nga subjektet e vetëdeklarimit? Nëse keni informacion mbi këtë aspekt, ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. Nëse informacioni juaj konsiston në opinione apo mendime, i shmangni informacionet specifike mbi reagimin e subjekteve të vlerësimit në këtë fazë.

(Këto janë pyetje që duhen bërë një nga një, gjatë intervistës. Numri i kërkesave/sugjerimeve/ankesave. Temat kryesore të tyre. Nga kush janë paraqitur këto reagime? Si janë paraqitur këto kërkesa/sugjerime/ankesa? Në mënyra formale? Në mënyrë joformale? A janë trajtuar ato nga autoritetet? A ka pasur seminare/seanca shpjeguese mbi formularët e vetëdeklarimit? Sa aktivitete të tilla janë zhvilluar? A ka pasur ekspertë (lokalë apo ndërkombëtare) të përfshirë në këtë fazë? A ka pasur asistencë ligjore falas për punonjësit e policisë gjatë plotësimit të vetëdeklarimit?

4. Sipas mendimit apo informacionit që keni, cili nga elementët e formularit të vetëdeklarimit është perceptuar si më i vështirë për t'u plotësuar: deklarata mbi pasurinë; deklarata mbi integritetin profesional apo deklarata mbi pastërtinë e figurës?
5. A kanë ndërtuar strukturat e vetingut sisteme të menaxhimit të informacionit të mbledhur nga vetëdeklarimi? Nëse jo, sipas mendimit tuaj, ky informacion duhet të digjitalizohet dhe të shërbejë për monitorimin në vazhdimësi në të ardhmen?
6. A ka aspekte të këtij procesi që janë kritikuar nga vetë subjektet e vlerësimit? Nga monitoruesit ndërkombëtarë? Nga publiku i gjerë? Jepni opinionin tuaj. Nëse keni raste konkrete, ju lutem përshkruani shqetësimin që kanë ngritur palët e interesit dhe nëse është adresuar apo jo.
7. Për raste të cilat janë në procesin e vlerësimit, a ka pasur nevojë që informacioni i vetëdeklaruar të rishikohej dhe të rishpjegohej për shkak të paqartësive apo keqkuptimeve në raportim? Nëse keni një opinion tuajin mbi këtë fakt nga

monitorimi i seancave të vlerësimit ju lutem shpreheni atë. Nëse keni informacion konkret, luteni ta përshkruani.

8. Cili është mendimi juaj mbi kapacitetet aktuale të sekretariatit dhe Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për përpunimin e informacionit të mbledhur gjatë fazës së vetëdeklarimit? Duke parë se ecuria e procesit është e ngadaltë, a mendoni se këto kapacitete duhen përmirësuar? Ngadalësia e procesit të vetingut është e lidhur me volumin e informacionit dhe vështirësinë e përpunimit, apo ka arsye të tjera që vetingu në policinë e shtetit po ecën me ritme të ngadalta?
9. A mendoni që në fund të fazës së parë të vlerësimit, duhet një reflektim mbi procedurat dhe kapacitetet në mënyrë që procesi të jetë më efikas, i paanshëm dhe i besueshëm për publikun dhe grupet e interesit? Nëse po, si mendoni të realizohet një vlerësim i tillë?
10. A duhet që vetë Komisioni i Vlerësimit të Jashtëm të ndërtojë një mekanizëm të vetëvlerësimit?
11. Po besueshmëria e vendimeve dhe aktivitetit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit a duhet të testohet në grupet e interesit dhe publiku i gjerë, para se procesi të kalojë në shkallën masive të zbatimit ku do të vlerësohen 3,000 punonjësit me grada të nivelit të mesëm dhe 9000 oficerë policie?

#### **Faza e përzgjedhjes rastësore - të rasteve të vlerësuar**

1. A ka qënë shorti i përzgjedhjes së rasteve të vlerësimit i lajmëruar, transparent dhe i besueshëm? A e keni ndjekur ju? A e ndjekin aq sa duhet media dhe publiku apo institucionet ndërkombëtare? A keni dëgjuar vlerësim mbi këtë proces? Cili është perceptimi mbi transparencën dhe besueshmërinë e tij? Ju lutem jepni opinionin tuaj.



### **SEKSIONI III: ASPEKTE TË VLERËSIMIT, ECURIA, IMPAKTI I DERITANISHËM DHE I PRITSHËM, SI NGA ANA E SUBJEKTEVE TË VLERËSIMIT ASHTU DHE NGA PERSPEKTIVA E PUBLIKUT**

1. Në dijeninë tuaj sa subjekte janë aktualisht pjesë e procesit të vlerësimit?

(Informacioni statistikor merret nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Ministria e Brendshme, ndërkohë që përgjigjet nga grupet e tjera të interesit do të interpretohen si pjesë e transparencës së procesit dhe ndjekjes nga publiku apo grupet e interesit.)

2. Seancat e vlerësimit janë të hapura dhe lajmërohen rregullisht nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. A jeni ju në dijeni të këtij fakti? A bëhen njoftimet në afate kohore të mjaftueshme që palët e interesuara t'i ndjekin? Cili është mendimi juaj për transparencën e këtyre seancave dhe përfshirjen në to të grupeve të interesit dhe publikut?
3. A keni marrë ju pjesë në ndonjë nga seancat e vlerësimit? Nëse po, me çfarë statusi?

#### **A. Pyetjet për anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit:**

- A ka qenë e lehtë të paraqitej informacioni (që nganjëherë krijon ndjeshmëri dhe reagime) në këto seanca?
- A do ishte më e lehtë të organizohen seanca dëgjimore jopublike me subjektin, dhe seancat publike të ishin në fazën finale?
- A rrit besueshmërinë e procesit fakti që seancat e vlerësimit bëhen publike?
- A cenohen të drejtat e njeriut, pasi ka informacione të subjektit të vlerësimit që janë të natyrës personale/private?
- Si ka qenë bashkëpunimi me institucionet ndihmëse të vetingut si DSIK-u, ILDKPKI-ja?
- A luajnë rol në këto seanca institucionet partnere, ato nga të cilat kërkohet të vërtetohet se informacioni i dhënë nga subjekti është autentik?

- Cilat nga këto institucione janë më efektive në dhënien e informacionit: institucionet private/ bankat/ institucionet publike/ sistemi i gjyqësorit/ prokuroria/ tatimet etj. Çfarë do të sugjeroni për të përmirësuar procesin e komunikimit?
- Çfarë sugjeroni se duhet të ndryshohet apo përmirësohet në këto seanca?
- A mendoni se mbulimi financiar i procesit të vetingut është i mjaftueshëm dhe sa transparent është ky proces?
- Si janë procedurat e shqyrtimit të denoncimeve nga publiku? Sa denoncime ka pasur deri më tani dhe cila ka qenë natyra e denoncimeve?

#### **B. Aspekte specifike të seancave dëgjimore me subjektet e vetingut**

- A mendoni se koha e shpalljes së vendimeve për subjektet e vetingut është e mjaftueshme?
- A mendoni se është e nevojshme të rregullohen praktikat e dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit për të qenë në përputhshmëri me afatet e përcaktuara në ligj?

#### **C. Pyetje për autoritetet publike/institucione ndërkombëtare si monitorues të procesit (Ministria e Brendshme, Nënkomisioni për mbikëqyrjen e vetingut, SHÇBA-ja)**

- A është monitorimi i seancave të vlerësimit i mundur dhe transparent për ju si autoritete publike?
- Nëse ju keni monitoruar/ndjekur seancat e vlerësimit, cili ka qenë qëllimi i këtij monitorimi: vlerësimi i procesit, lehtësimi, mbështetje për subjektet, mbështetje për autoritetet, është funksion i punës suaj etj.
- A ndihmon procesi i monitorimit në rritjen e profesionalizmit dhe transparencës së procesit?
- A dëmton ky monitorim paanshmërinë e procesit? Ndoshta Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ndihet i monitoruar nga ju si autoritete?
- A ka pasur ndonjë "lesson learned" gjatë

monitorimit? Të sugjerohet ndonjë përmirësim në kapacitete të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, përmirësim infrastrukture, procedurash etj.

#### **Ç. Pyetje për subjektet e vlerësimit:**

- Si e keni përjetuar ju këtë proces vlerësimi?
- A ka qenë procesi i vetëdeklarimit i vështirë? Çfarë formash komunikimi keni përdorur dhe a kanë qenë ato efektive?
- A keni pasur të gjithë informacionin e duhur për t'u përgatitur për procesin?
- A kanë qenë të përshtatshme dhe në kohën e duhur njoftimet e KJV-së për t'iu mundësuar të përgatiteni?
- A jeni pyetur dhe dëgjuar sa duhet dhe si duhet gjatë procesit?
- A keni ndier në ndonjë moment që është cenuar privatësia juaj?
- Çfarë mendoni se duhet të ndryshohet në mënyrën se si menaxhohet informacioni nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit? Si bëhet publik? Si realizohen njoftimet dhe seancat e vlerësimit?

#### **D. Pyetje për përfaqësues të grupeve të interesit (duke përfshirë shoqërinë civile, median apo sindikatën e policisë):**

- A keni pasur mundësi të ndiqni seancat të vlerësimit?
- Sa nga ato i keni ndjekur?
- A kishit informacion para se të ndiqnit seancën?
- Si jeni informuar mbi seancat dhe informacionin që do të diskutohej aty? A e merrni këtë informacion nëpërmjet portalit të KJV-së? Përmes shkresave zyrtare? Me mënyra direkte (formale) komunikimi? Mënyra direkte (joformale) komunikimi? A bëhet informimi mbi seancat në kohën e duhur?
- Për mendimin tuaj sa shterues është kontrolli i pasurisë, figurës dhe profesionalizmit në këtë proces? Sa i paanshëm dhe sa transparent?
- Cila ka qenë arsyeja që ju monitoroni këto seanca?

- A mendoni se monitorimi i tyre e bën procesin me transparent dhe të besueshëm?
- Po ndikimi i monitoruesve të jashtëm a cenon privatësinë e subjektit?
- A mendoni se ka aspekte të procedurës, përpunimit të informacionit apo komunikimit që duhen përmirësuar?

## SHTOJCA NR.2: MATRICA E TREGUESVE TË VLERËSIMIT

	TREGUES TË PROGRESIT	TREGUES TË REZULTATEVE/ IMPAKTIT	TREGUES TË TRANSPARENCËS DHE BESUESHMËRISË	BURIMI I INFORMACIONIT
<b>KUADRI LIGJOR</b>	<p>numri i seancave konsultuese;</p> <p>numri i akteve ligjore të miratuara;</p> <p>numri i akteve nënligjore të miratuara;</p> <p>numri i akteve administrative të miratuara.</p>	<p>numri i rekomandimeve/ sugjerimeve të nxjerra nga procesi i konsultimeve;</p> <p>numri i rekomandimeve/ sugjerimeve të pasqyruara në aktet ligjore.</p>	<p>numri i pjesëmarrësve në proceset konsultuese;</p> <p>lista e institucioneve/ grupeve të konsultuara.</p>	<p>të dhëna administrative;</p> <p>raporte zyrtare;</p> <p>intervista.</p>
<b>KUADRI INSTITUCIONAL</b>	<p>numri i strukturave të reja të krijuara;</p> <p>numri i strukturave që pritet të krijohen deri në fund të procesit;</p> <p>numri aktual i stafit të angazhuar në procesin e vetingut;</p> <p>numri aktual i stafit teknik mbështetës;</p> <p>buxheti (3 vjeçar) i institucioneve të vetingut në polici;</p> <p>numri i trajnimeve për stafin e vetingut;</p> <p>numri i pjesëmarrësve në trajnime;</p> <p>sistemet funksionale të informacionit</p> <p>(po/ jo - web)</p> <p>(database -po/ jo)</p>	<p>koha e krijimit të strukturës kundrejt planifikimit;</p> <p>buxheti faktik kundrejt Planit Buxhetor;</p> <p>numri i personave të certifikuar në trajnimet për vetingun;</p>	<p>publikimi i rregulloreve; (po/ jo, ose numri i rregulloreve të publikuara kundrejt atyre në total)</p> <p>Publikimi i CV-ve dhe bio-ve të stafit;</p> <p>(% e atyre të publikuara kundrejt stafit në total)</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista</p>

	<b>TREGUES TË PROGRESIT</b>	<b>TREGUES TË REZULTATEVE/ IMPAKTIT</b>	<b>TREGUES TË TRANSPARENCËS DHE BESUESHMËRISË</b>	<b>BURIMI I INFORMACIONIT</b>
	<p>ndarja gjinore e stafit (meshkuj/femra);</p> <p>raporti i stafit me numrin e rasteve aktuale të vlerësimit;</p> <p>buxheti faktik për burimet njerëzore kundrejt buxhetit operacional;</p>	<p>statistika përshkruese të stafit si: moshë, edukimi, numri i viteve të përvojës, sektorët nga vjen përvoja, meshkuj/femra</p>		<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista</p>
	<p>numri i procedurave të prokurimit;</p> <p>raport-buxheti total kundrejt buxhetit operacional logjistik</p>	<p>logjistika mbështetëse (kompjuterë, komunikim, makina, zyra)</p>	<p>aspekte procedurale të menaxhimit të buxhetit dhe prokurimeve</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista</p>
	<p>numri i ekspertëve të angazhuar në ngritjen e institucionit</p>	<p>numri i materialeve/ sistemeve të krijuara (web, databaze, etj.)</p>	<p>transparenca e ekspertizës së përfshirë/ transparenca në përzgjedhje (prokurim)</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista</p>
<b>PROCESI I VLERËSIMIT/ VETËVLERËSIMIT</b>	<p>numri i seancave të konsultimit mbi formularin e vlerësimit;</p> <p>numri i rekomandimeve;</p> <p>numri i pjesëmarrësve;</p> <p>numri i grupeve të interesit të përfshira (lista e autoriteteve të konsultuara);</p>	<p>numri i rekomandimeve të dhëna;</p> <p>numri i rekomandimeve të pasqyruara;</p>	<p>numri i grupeve të interesit të përfshira në diskutim;</p> <p>njoftimi publik dhe transparenca e diskutimeve;</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/ monitorimi i seancave të vlerësimit</p>

	<b>TREGUES TË PROGRESIT</b>	<b>TREGUES TË REZULTATEVE/ IMPAKTIT</b>	<b>TREGUES TË TRANSPARENCËS DHE BESUESHMËRISË</b>	<b>BURIMI I INFORMACIONIT</b>
	<p>numri i vetëdeklarimeve;</p> <p>numri i personave të dorëhequr;</p>	<p>numri i deklarimeve sipas gjinisë, moshës, përvojës dhe gradave;</p>		<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/</p> <p>monitorimi i seancave të vlerësimit</p>
	<p>numri i ekspertëve ligjorë të përfshirë në procesin e vetëdeklarimit;</p> <p>numri i asistencave ligjore të dhëna;</p> <p>numri i kërkesave për asistencë të marra gjatë vetëdeklarimit;</p>	<p>numri i seancave shpjeguese;</p> <p>numri i asistencës ligjore të përfituar;</p> <p>numri i kërkesave; ankesave;</p> <p>temat kryesore mbi të cilat ka pasur paqartësi;</p>	<p>numri i kërkesave të trajtuara;</p> <p>mënyrat si janë parashtruar ankesat/ kërkesat për ndihmë;</p> <p>numri i materialeve/ guidave shpjeguese të printuara dhe shpërndara gjatë procesit të vetëdeklarimit;</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/ monitorimi i seancave të vlerësimit</p>
	<p>numri (dhe lista) e institucioneve publike që kanë bashkëpunuar gjatë procesit të vetingut;</p> <p>koha mesatare e dërgimit të përgjigjeve ndaj shkresave të dërguara nga KJV-ja sipas çdo institucioni;</p>	<p>koha mesatare e marrjes së përgjigjeve ndaj shkresave të dërguara nga KJV-ja sipas çdo institucioni;</p> <p>numri i shkresave që keni shkëmbyer me institucionet publike;</p> <p>numri i shkresave për të cilat nuk keni marrë përgjigje kundrejt totalit;</p>	<p>numri i aktiviteteve publike të organizuara në bashkëpunim me institucione të tjera publike në lidhje me vetingun në polici;</p> <p>temat e aktiviteteve;</p> <p>publikime të përbashkëta;</p> <p>mesazhe të përbashkëta në media;</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/ monitorimi i seancave të vlerësimit</p>

	<b>TREGUES TË PROGRESIT</b>	<b>TREGUES TË REZULTATEVE/ IMPAKTIT</b>	<b>TREGUES TË TRANSPARENCËS DHE BESUESHMËRISË</b>	<b>BURIMI I INFORMACIONIT</b>
	<p>numri i raporteve dhe studimeve të hartuara mbi vetingun;</p> <p>numri i partnerëve të përfshirë në proces (lista e partnerëve)</p>	<p>perceptimi i publikut mbi procesin e vetëdeklarimit;</p> <p>vlerësimi i vetingut në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë;</p> <p>vlerësimi nga institucione të tjera ndërkombëtare;</p>		<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/</p> <p>monitorimi i seancave të vlerësimit</p>
	<p>numri i subjekteve të vlerësuara kundrejt numrit që planifikohej të vlerësohej;</p> <p>numri i rasteve nga subjektet e vlerësuara ku shpjegimi dhe rishikimi i formularit të vetëvlerësimit ka qenë i domosdoshëm për t'u qartësuar (% ndaj totalit të vlerësuar).</p>		<p>numri i personave të intervistuar që kanë marrë pjesë në seancat e vlerësimit në total; mesatarja për çdo seancë</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/</p> <p>monitorimi i seancave të vlerësimit</p>
	<p>numri i ankesave mbi cenimin e të drejtave të njeriut nëse ka pasur/ Numri i rasteve që do të raportohen nga intervistat si cenim i privatësisë dhe të drejtave të njeriut</p>	<p>numri i ankesave të trajtuara si shkelje e privatësisë/ të drejtave të njeriut</p>	<p>numri i personave të intervistuar që kanë marrë pjesë në seancat e vlerësimit në total; mesatarja për çdo seancë</p>	<p>të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/</p> <p>monitorimi i seancave të vlerësimit</p>

	<b>TREGUES TË PROGRESIT</b>	<b>TREGUES TË REZULTATEVE/ IMPAKTIT</b>	<b>TREGUES TË TRANSPARENCËS DHE BESUESHMËRISË</b>	<b>BURIMI I INFORMACIONIT</b>
	numri i ankesave/ kërkesave të ardhura nga publiku në lidhje me procesin e vetingut (2) temat kryesore (3) trajtimi i kërkesave nga publiku	numri i ankesave/ kërkesave të trajtuara të ardhura nga publiku	opinionit për transparencën e këtyre seancave dhe përfshirjen në to të grupeve të interesit dhe publikut nga të intervistuarit	të dhëna administrative/ raporte zyrtare/ intervista/  monitorimi i seancave të vlerësimit
			opinion nga intervistimi mbi cenimin e privatësisë dhe të drejtave të njeriut nga procesi	të dhëna administrative/  raporte zyrtare/ intervista/ monitorimi i seancave të vlerësimit

### **SHTOJCA NR. 3: LISTA E INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË INTERVISTAT E THELLUARA**

<b>NUMRI I TË INTERVISTUARVE</b>	<b>GRUPI I INTERESIT</b>
2	Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit
2	Sekretariati Teknik
1	SHCBA
1	Subjekt i Vetëgut -SHCBA
4	Subjekte të Vetëgut
1	Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit
1	Media



